



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më __.__.2024

VENDIM

Nr. 153, datë 27.03.2024

PËR

**VLERËSIMIN ETIK DHE PROFESIONAL TË GJYQTARES {...}, ME QËLLIM
GRADIMI, PËR PERIUdhËN E VLERËSIMIT 2013-2016**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenin 95 dhe 171 pika 5, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor, nr. 263, datë 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve” dhe nr. 264, datë 21.11.2019, “Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit”, pasi shqyrtoi “Projektraportin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtares {...}, me qëllim gradimi për periudhën e vlerësimit 2013-2016”, i hartuar nga relatore znj. Yllka Rupa,

V E N D O S I :

1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional, me qëllim gradimi, të gjyqtares {...}, për periudhën e vlerësimit 2013-2016”, duke e vlerësuar atë si më poshtë:
 - A. Aftësitë profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
 - B. Aftësitë organizative – “Shkëlqyeshëm”;
 - C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
 - D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm”.
Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shkëlqyeshëm”.
2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

ANALIZA E TË DHËNAVE TË MARRA NGA BURIMET E VLERËSIMIT DHE PROPOZIMI PËR NIVELIN E VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI

1. AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARES

Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtares në drejtim të aspekteve të njohurive ligjore dhe arsyetimit të vendimit, vlerësuesi përqendrohet në metodologjinë e përgjithshme të punës së gjyqtares bazuar në dosjet e përzgjedhura dhe nuk vlerëson meritat ligjore të vendimeve individuale, të cilat përcaktohen vetëm në kuadër të një procesi ankimi. Aftësia profesionale e gjyqtares pikëzohet sipas dy treguesve, njohuritë ligjore dhe arsyetimi ligjor, të cilët ndahen në disa nën tregues.

1.A. NJOHURITË LIGJORE

1.A.A AFTËSIA PËR TË IDENTIFIKUAR NATYRËN E ÇËSHTJES, LIGJIN E ZBATUESHËM DHE/OSE KONFLIKTIN E NORMAVE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja dhe 1 vendim i administruar për shkak të ankesave);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se “Subjekti i rivlerësimit {...} ka

aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara, është konstatuar se ajo identifikon normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye të qarta për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret.

Ka njohuri për rëndësinë e natyrës se mosmarrëveshjes lidhur me zgjidhjen e çështjes (shih dokumentet nr.1, 2 e 3 dhe dosjen nr. 1, 2, 3, 4, 5. Ka njohuri në fushat civile të përgjithshme, identifikon ligjin e posaçëm që duhet zbatuar dhe interpreton drejt atë, duke saktësuar vendimin e gjykatës së shkallës së parë, (shih dokumentin 1), ka njohuri në fushën administrative, ku gjyqtarja ka dhënë vendime si gjyqtarë e deleguan në Gjykatën Administrative të Apelit Tirane, duke e gjykuar çështjen dhe vendosur ndryshimin e vendimit të shkallës së parë, (shih dokumentin nr. 3). Ka njohuri në fushën penale, duke vlerësuar drejt rrethanat e çështjes, aplikon gjykimin posaçëm, gjykimin i shkurtuar, saktëson pjesën e cilësimit ligjor të veprës penale, saktëson masat e dënimit, (shih dosjen 3, 4, 5). Parimet e përgjithshme të teorisë së të drejtës, ka raste që janë përdorur nga gjykata. Në rastin e dokumentit nr. 1, gjyqtarja ka përdorur parimin e rënies në dekadencë të kërkesa që nuk janë propozuar rishtas në ankim, parashikuar nga nenin 450 i K.Pr.Civile. Në dokumentin 2, gjyqtarja analizon mënyrat e fitimit të pronësisë, duke ndryshuar pjesërisht vendimi të gjykatës së faktit. Në disa raste, në funksion të zbatimit të ligjit, subjekti përdor referenca nga jurisprudence Unifikues e Gjykatës së Larte (shih dokumentet nr. 2 dhe 3, si dhe dosja 3). Në disa raste gjykata i referohet ligjit specifik, duke identifikuar sakte natyrën e çështjes,(dokumentin 3, dosjen nr. 1)”.

Nga analiza e të gjithë burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se:

- Në lidhje me përshkrimin e fakteve të çështjes:

Referuar burimeve të vlerësimit, evidentohet se gjyqtarja përshkruan faktet dhe rrethanat e çështjes, në përputhje me provat e lejuara dhe të marra në shqyrtim gjatë gjykimit në shkallë të parë. Duke u nisur nga mënyra se si janë inkorporuar rrethanat e çështjes pothuajse në të gjitha vendimet të analizuara, vlen të theksohet se pavarësisht natyrës së gjykimit (*gjykim penal themeli, apo çështje civile themeli*), apo natyrës të gjykimit të zhvilluar (*mbi shkaqet e ankimit*), rrethanat e fakteve parashtrohen në fillim të pjesës përshkruese-arsyetuese të vendimit, pas parashtrimit të rrethanave procedurale në lidhje me procedimin sipas ritit të gjykimit të shkurtuar në gjykimin në shkallë të parë. Pavarësisht se nga ana e gjyqtarës nuk rezulton që faktet të pasqyrohen në një nën-pjesë të titulluar “Rrethanat e faktit”, mënyra se si ato janë përshkruar në fillim të pjesës përshkruese-arsyetuese të vendimeve e bëjnë atë lehtësisht të dallueshme dhe të kuptueshme për lexuesin.

Gjyqtarja i kushton rëndësi nxjerrjes së faktit juridik (*civil apo penal*), fakt ky, që nuk i referohet vetëm asaj çfarë kanë prezantuar palët në ankim apo qëndrimet e tyre gjatë gjykimit në apel por, duke integruar provat e administruara gjatë gjykimit dhe vlerësimin e gjykatës së shkallës së parë mbi to, në rastet kur vendimi i ankimit gjendet i drejtë. Në disa vendime gjyqësore, rrethanat e çështjes pasqyrohen shkurt, kjo e kushtëzuar nga shkaqet e ankimit ndaj vendimit (*p.sh kur pala*

*ankuese ankimon vendimin e shkallës së parë vetëm përta i përket masës së dënimit dhe jo në lidhje me ekzistencën apo jo të faktit penal).*¹

Në tërësi në vendimet gjyqësore burim vlerësimi, rezulton se gjyqtarja ka treguar kujdes për nxjerrjen e fakteve, analizën dhe cilësimin juridik të tyre, pa u lidhur me atë çfarë kanë prezantuar palët, duke i dhënë vendimeve gjyqësore qartësi në drejtim të pasqyrimin të fakteve të provuara, duke orientuar më pas analizën e shkaqeve të ankimit vetëm në raport me faktet e vlerësuara si të provuara në gjykim.

- Në lidhje me identifikimin e natyrës së çështjes:

Nga përshkrimi dhe analiza e fakteve të çështjes dhe nxjerrja e fakteve juridike të provuara në gjykim, gjyqtarja përcakton natyrën e mosmarrëveshjes apo çështjes objekt shqyrtimi. Përcaktimit në mënyrë të qartë të natyrës së marrëdhënies juridike të krijuar ndërmjet palëve i jepet rëndësia e duhur, jo vetëm sepse ky përcaktim ka lidhje të drejtpërdrejtë me kompetencën në lëndë dhe funksionin të gjykatës dhe që përbën edhe një nga shkaqet për prishjen e vendimit të shkallës së parë por, duke e konceptuar atë edhe si një element thelbësor për të orientuar analizën ligjore të gjykatës lidhur me zgjidhjen e çështjes. Në këtë kontekst, nga vlerësimi në tërësi i vendimeve gjyqësore burim vlerësimi, vihet re që, edhe pse jo e shprehur, gjyqtarja e përcakton natyrën e çështjes objekt shqyrtimi, nëse natyra juridike e çështjes është civile apo penale themeli.

- Në drejtim të përcaktimit të ligjit të zbatueshëm:

Përcaktimi i saktë i natyrës së çështjes nuk ka lidhje të drejtpërdrejtë vetëm me kompetencën lëndore dhe funksionale të gjykatës për shqyrtimin e çështjes por, gjithashtu lidhet me identifikimin e ligjit të zbatueshëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjes. Në këtë aspekt, referuar burimeve të vlerësimit, evidentohet se gjyqtarja identifikon dhe citon ligjin e zbatueshëm, duke treguar gjithashtu kujdes në mos citimin apo listimin e dispozitave ligjore materiale të cilat nuk kanë lidhje dhe nuk referojnë në zgjidhjen e mosmarrëveshjes objekt shqyrtimi. Duke i ndarë vendimet gjyqësore objekt vlerësimi në dy kategori (*i*) vendime civile dhe (*ii*) vendime penale, në lidhje me identifikimin e ligjit të zbatueshëm material, por edhe atij procedural të aplikueshëm për zgjidhjen e çështjes, konstatohet se:

Në vendimet civile (*shpërblim demi, detyrim pagim shume, shfuqizim vendimi, pavlefshmëri urdhri ekzekutimi etj.*), gjyqtarja identifikon ligjin material dhe procedural të zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes duke iu referuar dispozitave materiale të Kodit Civil dhe Kodit të Procedurës Civile, por edhe dispozita të ligjeve të posaçëm kur ato vijnë në shërbim të analizës lidhur me zgjidhjen e

¹ *Vendimi nr.15, datë 14.01.2015, vendimi nr. 2224, datë 23.12.2015, vendimi nr.72, datë 26.01.2015;*

çështjes. Konkretisht, në vendimet burim vlerësimi, identifikohen, referohen dhe citohen dispozitat me karakter procedural dhe material, si më poshtë:

- neni 31 i Kodit të Procedurës Civile, në lidhje me të drejtën për të ngritur padi, neni 8, 12, 16 Kodit të Procedurës Civile sa i përket barrës së provës, neni 296, të Kodit Civil në lidhje me të drejtën pronarit për kthimin e sendit, neni 136 i Kodit Civil, në lidhje me detyrimin e pronarit të sendit për të provuar faktin se pronësia rrjedh nga një mënyre e ligjshme e fitimit të pronësisë²;
- Nenin 681 i Kodit Civil në lidhje me interpretimin e kontratës sa i përket elementeve formale të kontratës, neni 618 i Kodit Civil në lidhje me përgjegjësinë për shkaktimin e dëmit³.
- nenin 608, 609 të K.Civil në lidhje me dëmin jashtëkontraktor, me qëllim përcaktimin e kriterëve që duhet të ekzistojnë së bashku që të ekzistojë lidhja shkakësore (*i drejtpërdrejtë dhe i menjëhershëm*)⁴.
- Neni 118 i Kodit të Procedurës Civile, në lidhje me pavlefshmërinë e relative të aktit administrativ⁵

Në vendimet penale të themelit, gjyqtarja identifikon dispozitat materiale e procedurale penale të sanksionuara në pjesën e posaçme të Kodin Penal, në funksion të analizimit dhe vlerësimit që i bëhet cilësimit juridik të faktit penal që i atribuohet të pandehurit, dhe dispozita të pjesës së përgjithshme, kryesisht lidhur me, përcaktimin e dënimit, rrethanave renduese, lehtësuese. Konkretisht, gjyqtarja identifikon:

- nenin 278/3 të Kodit Penal në lidhje me cilësimin juridik të faktit në raport me elementët e veprës penale të « Prodhim dhe mbajtje pa leje e armëve luftarake»⁶;
- nenin 121/a të K. Penal në lidhje me akuzën e “Përndjekja”⁷;
- nenin 47 lidhur me individualizimin e dënimit⁸ dhe nenin 59 të Kodit Penal lidhur kushtet dhe kriteret e aplikimit të alternativës së dënimit me burgim⁹;
- neni 130/a/2 i K. Penal në lidhje me veprën penale të “ Dhunës në Familje”¹⁰,
- nenin 134/2 të K. Penal në lidhje me akuzën e veprës penale të “Vjedhja”¹¹
- nenin 135-25 të K. Penal në lidhje me akuzën e veprës penale të “Vjedhja duke shpërdoruar detyrën”¹²
- neni 89 i Kodit Penal në lidhje me akuzën e veprës penale të “Plagosjes së lehtë me dashje”¹³
- neni 197 i Kodit Penal në lidhje me akuzën e veprës penale të “Organizimi i lotarive të palejuara”¹⁴

²Vendimi civil nr. 3539, datë 27.10.2014 i Gjykatës së Apelit Tirane

³Vendimi nr. 3536, datë 16.05.2014,

⁴Vendimi nr.2586, datë 11.06.2014

⁵Vendimi nr.32, datë 20.03.2013 i Gjykatës së Apelit Tiranë

⁶ Vendimi nr. 72, datë 26.01.2015 Gjykatës së Apelit Tiranë

⁷ Vendimi nr. 1021, datë 20.07.2016 Gjykatës së Apelit Tiranë

⁸ Vendimi nr. 1949, datë 11.11.2015. Gjykatës së Apelit Tiranë

⁹ Vendimi nr. 1949, datë 11.11.2015 i Gjykatës së Apelit Tiranë; Vendimi nr. 1042, datë 27.05.2015 Gjykatës së Apelit Tiranë; Vendimi nr. 15, datë 14.01.2015 i Gjykatës së Apelit Tiranë

¹⁰ Vendimi nr. 1021, datë 20.07.2016; Vendimi nr. 2224, datë 23.12.2015 Gjykatës së Apelit Tiranë

¹¹ Vendimi nr. 1042, datë 27.05.2015 Gjykatës së Apelit Tiranë

¹² Vendimi nr. 1023, datë 22.05.2015 Gjykatës së Apelit Tiranë

¹³ Vendimi nr. 2224, datë 23.12.2015 Gjykatës së Apelit Tiranë Gjykatës së Apelit Tiranë

- nenin 291 të K. Penal në lidhje me akuzën e “Drejtimit të mjetit në mënyrë të parregullt”

Në vendimet penale burim vlerësimi rezulton citimi dhe analiza e dispozitave procedurale penale, lidhur me vlerësimin e shkaqeve të ankimit që konsistojnë në elementë të procedurës, si dhe në rastet kur çështja objekt shqyrtimi është e natyrës procedurale dhe konkretisht:

- neni 152 të K.Pr.P lidhur me vlerësimin e ligjshmërisë së marrjes dhe vlerësimit të provave në drejtim të mbështetjes së bindjes së brendshme të gjykatës¹⁵;
- Në çdo rast, gjyqtarja referohen dispozita të Kodit Penal, të pjesës së posaçme në lidhje me veprat penale për të cilat procedohet, si dhe dispozita të pjesës së përgjithshme të Kodit Penal, p.sh në lidhje me kriteret dhe parimet në caktimin e llojit dhe masës së dënimit (neni 47 i K. Penal), rrethanat lehtësuese dhe rënduese (nenet 48, 49 dhe 50 të K. Penal),¹⁶;
- Neni 406/1 i Kodit të Procedurës Penale sa i përket masës së dënimit për efekt të gjykimit të posaçëm.

Gjyqtarja identifikon dispozita të ligjeve dhe akteve nënligjore të posaçme që gjejnë zbatim në zgjidhjen e çështjeve, si më poshtë:

- Ligji me nr.8549 datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”
- VKM nr. 360 datë 14.07.200 “Për lirimimin e nga shërbimi civil”
- Ligji nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”
- Ligji me nr.9216 date 1.04.2004 “ Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin me nr. 7829 date 01.06.1994 “Për Noterinë” i ndryshuar me ligjin 8970 datë 10.05.2001.
- Ligji me nr. 8662 date 18.09.2000 “Për trajtimin si titull ekzekutiv të faturës së konsumit të energjisë elektrik ”
- Ligji me nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”
- VKM 343 date 11.07.2002 “Për pajisjen me numër telefonik celular për personat juridik ”.

Krahas dispozitave dhe ligjeve të posaçme si më sipër, gjyqtarja ka identifikuar dhe referuar si ligj të zbatueshëm edhe dispozita akteve ndërkombëtare që përbëjnë burim të së drejtës:

- Rekomandimi i Këshillit të Evropës nr. (99) 22 i Komisionit të Ministrave për Shtetet Anëtare në lidhje me mbipopullimin e burgjeve,

Në një prej vendimeve burim vlerësimi, nuk rezulton që gjyqtarja të ketë evidentuar dhe referuar në mënyrë të shprehur dispozita të ligjit procedural dhe/ose material të zbatueshëm, duke e orientuar analizën e çështjes në vlerësimin e fakteve dhe shkaqeve të ankimit, duke konsideruar ligjin e

¹⁴ Vendimi nr. 195, datë 23.02.2015 Gjykatës së Apelit Tiranë Gjykatës së Apelit Tiranë

¹⁵ Vendimi nr. 1949, datë 11.11.2015 Gjykatës së Apelit Tiranë ; Vendimi nr. 1023, datë 20.07.2016 Gjykatës së Apelit Tiranë

¹⁶ Vendimi nr. 1949, datë 11.11.2015 ; Vendimi nr. 1021, datë 20.07.2016 Gjykatës së Apelit Tiranë; Vendimi nr. 15, datë 14.01.2015 i Gjykatës së Apelit Tiranë

zbatueshëm në vlerësimin e tyre, por pa e përcaktuar dhe referuar atë në mënyrë të qartë në arsyetim.¹⁷

Sa i përket konfliktit të normave, në vendimet gjyqësore burim vlerësimi, nuk konstatohet që të jetë evidentuar nga gjyqtarja ndonjë rast i konfliktit të normave ligjore për të evidentuar mënyrën dhe se si do të gjente zbatim një konflikt i tillë në rastin konkret. Nga ana tjetër, nuk konstatohet asnjë rast ku analiza e konfliktit të normave të ketë qenë e domosdoshme, në mbështetje të arsyetimit, lidhur me zgjidhjen e çështjes.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira për identifikimin e qartë dhe të plotë të fakteve të çështjes, identifikimin e natyrës së çështjes, si dhe identifikimin e normës/normave konkrete procedurale dhe/ose materiale që gjejnë zbatim në zgjidhjen e çështjes konkrete.

Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësoj se aftësia e gjyqtares për këtë tregues, duhet të vlerësohet “Shumë e lartë”, duke u pikëzuar me 25 pikë.

1.A.B. AFTËSIA PËR TË INTERPRETUAR LIGJIN NË ZGJIDHJEN E ÇËSHTJES

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja dhe 1 vendim i administruar për shkak të ankesave);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se “Ka njohuri për rëndësinë e natyrës së mosmarrëveshjes lidhur me zgjidhjen e çështjes (shih dokumentet nr.1, 2 e 3 dhe dosjen

¹⁷Vendimi nr.2500, datë 06.06.2014 i Gjykatës së Apelit Tiranë

nr. 1, 2, 3, 4, 5. Ka njohuri në fushat civile të përgjithshme, identifikon ligjin e posaçëm që duhet zbatuar dhe interpreton drejt atë, duke saktësuar vendimin e gjykatës së shkallës së parë, (shih dokumentin 1), ka njohuri në fushën administrative, ku gjyqtarja ka dhënë vendime si gjyqtarë e deleguan në Gjykatën Administrative të Apelit Tirane, duke e gjykuar çështjen dhe vendosur ndryshimin e vendimit të shkallës së parë, (shih dokumentin nr. 3) Ka njohuri në fushën penale, duke vlerësuar drejt rrethanat e çështjes, aplikon gjykimin posaçëm, gjykimin i shkurtuar, saktëson pjesën e cilësimit ligjor të veprës penale, saktëson masat e dënimit, (shih dosjen 3, 4, 5). Parimet e përgjithshme të teorisë së të drejtës, ka raste që janë përdorur nga gjykata. Në rastin e dokumentit nr. 1, gjyqtarja ka përdorur parimin e rënies në dekadencë të kërkesa që nuk janë propozuar rishtas në ankim, parashikuar nga nenin 450 i K.Pr. Civile. Në dokumentin 2, gjyqtarja analizon mënyrat e fitimit të pronësisë, duke ndryshuar pjesërisht vendimi e gjykatës së faktit. Në disa raste, në funksion të zbatimit të ligjit, subjekti përdor referenca nga jurisprudence Unifikues e Gjykatës së Lartë (shih dokumentet nr. 2 dhe 3, si dhe dosja 3). Në disa raste gjykata i referohet ligjit specifik, duke identifikuar sakte natyrën e çështjes, (dokumentin 3, dosjen nr. 1)”.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se:

Në vendimet objekt vlerësimi, identifikimi i normës juridike (*kryesisht asaj materiale - civile ose penale apo procedurale*) si ligj i zbatueshëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjes, bëhet në shërbim të analizës juridike të fakteve objekt shqyrtimi, duke sjellë si rrjedhojë logjike konkluzionin e arritur nga gjyqtarja lidhur me zbatimin e saj.

Përgjithësisht, interpretimi i normës juridike bëhet duke identifikuar në mënyrë specifike qëllimin, funksionin, apo duke përcaktuar kushtet dhe kriteret që duhet të plotësohen në mënyrë kumulative që të gjejë zbatim norma konkrete, në raport me faktet e provuara në gjykim.

Konkretisht, në mënyrë më specifike në disa prej vendimeve penale burim vlerësimi, evidentohet se gjyqtarja interpreton dispozitat materiale Kodit Penal në funksion të cilësimit juridik të veprës penale dhe përgjegjësisë së autorit në kryerjen e saj, duke bërë zbërthimin e normave të pjesës së posaçme të Kodit Penal, në funksion të analizës së elementëve të figurës së veprës penale për të cilën procedohet. Gjyqtarja interpreton në nivel teorik normën relevante të K. Penal, duke bërë një përshkrim të përgjithshëm në lidhje me elementët dallues të veprës penale, dhe në vijim, duke e përqsaur me faktet e provuara në gjykim, nxjerr konkluzionin në lidhje me cilësimin juridik të faktit penal dhe përgjegjësinë penale të autorit.¹⁸ Ndërkohë, në disa prej vendimeve burim vlerësimi, nuk konstatohet që të jetë bërë ndonjë interpretim teorik i normës relevante penale në lidhje me veprat penale përkatëse që i atribuohen të pandehurve, (*p.sh nenit 290/2, 291 apo nenit 89*), kjo për shkak se cilësimi i faktit juridik dhe përgjegjësia penale e autorit në lidhje me kryerjen e këtyre veprave penale nuk është bërë objekt kundërshtimi dhe ankimi në apel. Evidentohet interpretimi i dispozitave të pjesës së përgjithshme të Kodit Penal, p.sh në lidhje me individualizimin e dënimit

¹⁸Pothuajse në të gjitha vendimet penale.

(nenet 47, 48, 49, 50 të K. Penal), ose aplikimin apo jo të alternativave të dënimit (neni 59), në të gjitha ato raste kur shkak i ankimit ka të bëjë pikërisht me masën e dënimit, ose me aplikimin apo jo të alternativave të dënimit.¹⁹ Në funksion të interpretimit të nenit 59 të K. Penal, gjyqtarja referon Rekomandimin nr. R (99) 22 i Komitetit të Ministrave të Shteteve Anëtare, sipas të cilit “burgimi” duhet të zbatohet si masë vetëm “kur çdo masë apo sanksion tjetër do të ishin të papërshtatshme për rëndësinë e veprës”. Gjyqtarja interpreton dispozita të pjesës së përgjithshme të Kodit Penal edhe në lidhje me institutin e bashkëpunimit sipas parashikimeve të nenit 25 të Kodit Penal, duke analizuar në këtë drejtim elementët e anës objektive dhe subjektive të kryerjes së veprës në bashkëpunim.²⁰ Por, interpretimi i ligjit të zbatueshëm, nuk rezulton të jetë bërë në të njëjtën masë dhe me të njëjtën vëmendje në të gjitha vendimet burim vlerësimi pasi, në disa prej tyre, mungon sepse shkaqet e ankimit i referohen faktit dhe mënyrës së vlerësimit të provës dhe jo çështjeve që lidhen me interpretimin dhe zbatimin e ligjit material²¹. Normat ligjore të zbatueshme, kryesisht ato materiale, citohen duke u shoqëruar me interpretimin e tyre dhe aplikimin mbi faktet e çështjes. Interpretimi i dispozitave materiale bëhet nga ana e gjyqtarës sipas qëllimit dhe funksionit të tyre, në mbështetje të analizës juridike dhe zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Gjyqtarja referuar pretendimeve të ngritura nga ana e palëve në ankim, interpreton në përputhje me rrethanat e faktit, dispozitat procedurale që kanë lidhje me zgjidhjen e mosmarrëveshjes në mënyrë përfundimtare. Konkretisht interpreton nenin 152 të K.Pr.Penale, në funksion të pretendimeve të pandehurit të ngritura në ankim, në lidhje me mosprovimin e fajësisë, duke analizuar interesin e të pandehurit për kryerjen e veprës penale si një indicje e cila vlerësohet në raport me provat e tjera, duke i dhënë një interpretim të veçantë indicies si një element provueshmërie për ekzistencën e një fakti, duke cituar gjithashtu, kushtet që duhet të ekzistojnë që indicia të shërbejë si element provueshmërie për ekzistencën e faktit penal²².

Sa përket vendimet civile burim vlerësimi, Gjyqtarja interpreton ligjin e zbatueshëm (nenin 609,610 të K.Pr.Civile) në funksion të zgjidhjes së çështjes, jo vetëm në aspektin teorik të saj, duke identifikuar qëllimin e dispozitave por, duke e përputhur këtë interpretim me faktin dhe provat e administruara gjatë gjykimit²³. Interpreton nenin 608 të K.Civil në funksion të trajtimit të elementëve të padisë së kërkimit të dëmit jashtëkontraktor, duke përcaktuar kushtet për pasjen e dëmit jashtëkontraktor, e përkatësisht faktin e paligjshëm, dëmin e paligjshëm, lidhjen shkakësore dhe fajin, duke u ndalur në analizën e detajuar të konceptit të dëmit të paligjshëm. Gjithashtu interpreton nenin 31 i K.Pr.Civile që ka të bëjë me interesin e paditësit në ngritjen e padisë si një mjet procedural për mbrojtjen e interesit material.

Në lidhje me aftësinë e gjyqtarës për të përdorur jurisprudencën relevante.

¹⁹Vendimi nr.1949, datë 11.11.2015, vendimi nr.2224, datë 23.12.2015, Gjykatës së Apelit Tiranë

²⁰ Vendimi 1023, datë 22.05.2015 Gjykatës së Apelit Tiranë

²¹ Vendimi nr. 1023, datë 22.05.2015 i Gjykatës së Apelit Tiranë; Vendimi nr. 72 datë 26.01.2016 i Gjykatës së Apelit Tiranë;

²² Vendimi nr. 1023, datë 22.05.2015 i Gjykatës së Apelit Tiranë

²³ Vendimi nr. 2586, datë 11.06.2014, i Gjykatës së Apelit Tiranë

Në disa nga vendimet e analizuara rezulton se gjyqtarja ka identifikuar dhe përdorur jurisprudencën relevante vendimet Unifikues të Gjykatës së Lartë në mbështetje të argumenteve të saj konkretisht vendimit nr. 2 datë 29.01.2003 të Kolegjeve të Bashkuara në lidhje me kërkesat procedurale të aplikimi të gjyqimit të shkurtuar

Në lidhje me zbatimin e parimeve të përgjithshme të së drejtës, evidentohet se gjyqtarja në disa raste, gjatë interpretimit të ligjit të zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes, përmend dhe/ose zbaton parimet e përgjithshme të së drejtës, fakt i cili evidentohet duke iu referuar kontekstit të arsytimit dhe analizës ligjore të vendimit.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka shfaqur aftësi shumë të mira të interpretimit të ligjit procedural dhe material, në shërbim të konkluzioneve të arritura në lidhje me çështjen dhe, kur është e nevojshme, në mbështetje të arsytimit të vendimeve, ka identifikuar praktikën e Gjykatës së Lartë. Ky konkluzion bazohet në analizën e metodologjisë së përgjithshme të punës së gjyqtarës në drejtim të këtij treguesi, duke analizuar burimet e vlerësimit në tërësinë e tyre, pa i dhënë peshë dhe rëndësi të veçantë asnjërit prej tyre.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi:** Referuar sa më sipër, vlerësoj se shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes” duhet të vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 25 pikë.*

1.B. ARSYETIMI LIGJOR

1.B.A. QARTËSIA, KONCIZITETI DHE KUPTUESHMËRIA E VENDIMIT

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja dhe 1 vendim i administruar për shkak të ankesave);

- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se “Subjekti i rivlerësimit {...} ka aftësi në arsyetim ligjor. Vendimet gjyqësore përfundimtare të arsyetuara prej saj, janë të qarta dhe të kuptueshme. Në çdo rast respekton rregullat e drejtshkrimit, në funksion të qartësisë së arsyetimit të vendimit gjyqësor dhe përdor rregullisht karakteret e gjuhës shqipe, me përjashtim të germës "ë”.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, evidentohet se vendimet gjyqësore janë të qarta dhe të kuptueshme, duke u bërë të kuptueshëm edhe për një lexues të arsyeshëm, jo vetëm për njohësit e ligjit.

Nuk evidentohet përdorimi i fjalëve që cenojnë integritetin e personit, si dhe shmang përdorimin e fjalëve fyese apo denigruese.

Në arsyetimin e vendimeve evidentohet zbatimi i saktë i rregullave gramatikore dhe atyre të sintaksës. Evidentohet në mënyrë të veçantë në të gjitha vendimet gjyqësore përdorimi i të gjitha shkronjave të alfabetit shqip me përjashtim të germës (ë).

Gjuha teknike përdoret në mënyrë korrekte dhe konsistente, vetëm në rastet kur është i pashmangshëm përdorimi i saj, sikundër parashikohet shprehimisht p.sh. në ligjet e posaçme të përdorura nga ana e gjykatës në lidhje me ligjin e zbatueshëm, apo në aktet e ekspertimit të përdorur nga ekspertët me njohuri të posaçme, të ndryshme nga aktet juridike.

Në përdorimin e instituteve, parimeve, apo të drejtave të pjesëmarrësve në një procedim penal, nuk rezulton përdorimi i termave latine,²⁴ por parimet apo institutet përdoren në gjuhën shqipe.

Në arsyetimin e vendimeve evidentohet përdorimi i fjalive me gjatësi normale, të ndërthurura dhe të kuptueshme. Fjalitë janë rrjedhë logjike e njëra tjetrës dhe paragrafët e arsyetimit të vendimit, gjithashtu. Nuk rezultojnë të jenë përdorur terma apo fjalë që krijojnë paqartësi në lidhje me

²⁴Është e diskutueshme nëse përdorimi i fjalëve në latinisht e rrisin apo jo vlerën e një vendimi gjyqësor, duke qenë se konsiderohet si “gjuhë e vdekur”, ndërkohë që vetë jurisprudenca ndërkombëtare kryesisht ajo e GJEDNJ-së shumë terma juridikë i përdor në gjuhën e vjetër latine. Pavarësisht këtij diskutimi, nëse do të konsiderohej vlerë, ajo do të duhej gjithmonë të shoqërohej me kuptimin e saj në gjuhën shqipe me qëllim që ky parim apo institut të bëhej i kuptueshëm edhe nga mosnjohësit e ligjit.

kuptimin e tyre, apo të kontekstit në të cilin përdoren. Vendimi është i organizuar me paragrafë, duke kaluar mendimin nga një paragraf, në paragrafin tjetër.

Në tërësi, referuar burimeve të vlerësimit për këtë tregues, evidentohet se gjyqtarja ka aftësi të lartë të arsyetimit ligjor, në drejtim të qartësisë, koncizitetit dhe kuptueshmërisë së vendimit.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja {...} ka aftësi shumë të mira në drejtim të treguesit të qartësisë, koncizitetit dhe kuptueshmërisë së vendimit.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, vlerësoj se shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 15 pikë.

1.B.B. STRUKTURA E QËNDRUESHME DHE E MIRËORGANIZUAR E VENDIMIT

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja dhe 1 vendimi të administruara për shkak të ankesave);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se “Struktura e vendimeve të saj është e qëndrueshme, e mirëorganizuar dhe e standardizuar. Ajo përmban elementët e kërkuar nga legjislacioni procedural, civil e penal. Subjekti i rivlerësimit mban të njëjtin stil në hartimin e akteve dhe organizimi strukturor i vendimeve paraqitet në nivel të kënaqshëm.”.

Referuar burimeve të vlerësimit evidentohet se gjyqtarja në hartimin e vendimeve gjyqësore ndjek një strukturë të qëndrueshme dhe të mirëorganizuar, në përmbajtje të së cilës gjyqtarja i përmbahet

si prezantimit të fakteve, identifikimit të ligjit të zbatueshëm dhe lidhjes së tyre me konkluzionet e arritura. Gjithashtu, konstatohet se gjyqtarja ka një metodologji të qartë të strukturimit të pjesëve përbërëse të vendimit, duke iu përshtatur edhe gjykimit në apel, për shkak të së cilit i duhet të citojë edhe vendimmarrjen objekt ankimi, si dhe shkaqet e ankimit të palëve. Vendimet gjyqësore burim vlerësimi, përmbajnë pjesën hyrëse, pjesën përshkuese-arsyetuese, si dhe dispozitivin e vendimit.

Në pjesën hyrëse gjejnë pasqyrim të dhënave të regjistrimit, trupi gjykues dhe sekretarja gjyqësore, data e shqyrtimit, palët, objekti i shqyrtimit, disponimi i Gjykatës së Shkallës së Parë, si dhe kërkimet/ shkaqet e ankimit të subjekteve në gjykimin në Apel.

Pjesa përshkuese – arsyetuese është e organizuar paragrafë të patitulluar, por në aspektin e përmbajtjes, është e strukturuar duke marrë në analizë :

Pjesa përshkuese – arsyetuese është e ndarë në disa nën pjesë, edhe pse vizualisht jo me tituj të përcaktuar por, nga mënyra e pasqyrit të tyre në vendim konstatohet lehtë dhe dukshëm nëndarjet sipas rrjedhës logjike të strukturës së vendimit. Përgjithësisht, arsyetimi i vendimit strukturoret duke paraqitur :

- ✓ konkluzionin e gjykatës së apelit lidhur me çështjen, duke shprehur që në fillim të pjesës hyrëse vlerësimin nëse vendimi i gjykatës së shkallës së parë objekt ankimi është i drejtë dhe i bazuar dhe duhet të lihet në fuqi apo nëse ka vend për ndryshimin e tij;
- ✓ rrethanat dhe faktet e çështjes siç rezultojnë nga provat objekt shqyrtimi të cilat merren në analizë nga gjyqtarja, duke integruar në rastet e përsëritjes së shqyrtimit gjyqësor, edhe faktet që kanë rezultuar gjatë hetimit gjyqësor në apel;
- ✓ konkluzionin e gjykatës së shkallës së parë lidhur me zgjidhjen e çështjes, duke e paraqitur atë në mënyrë të përmbledhur duke referuar ose cituar pjesë nga arsyetimi i vendimit të ankimuar. Në disa raste janë cituar edhe pjesë nga përmbajtja e provave të administruara në gjykim, kur ato janë vlerësuar të rëndësishme për të dhënë qartësi arsyetimit të vendimit në vijim;
- ✓ rrethanat procedurale të gjykimit në shkallë të parë si dhe ato të gjykimit në apel;
- ✓ vlerësimin e gjykatës së apelit mbi shkaqet e ankimit, paraqitur në formën e një konkluzioni,
- ✓ për të vijuar me arsyetimin ligjor dhe argumentet e gjykatës lidhur me secilin shkak ankimi apo edhe në raport me çështjen në tërësi.

Në shumicën e çështjeve dhe posaçërisht në ato çështje kur shkaqet e ankimit konsistojnë në elementë që kanë të bëjnë me çështje të themelit, pavarësisht konkluzionit mbi faktet e pranuar nga gjykata e shkallës së parë, gjyqtarja rimerr në analizë secilin prej tyre, në raport me shkaqet e ankimit, duke i rivlerësuar dhe analizuar sërish faktet, në mbështetje të argumenteve të tij për bazueshmërinë ose jo të shkaqeve të ankimit objekt shqyrtimi nga gjykata e apelit. Arsyetimi përmbillet me ritheksimin e konkluzionit të gjykatës së apelit mbi zgjidhjen e çështjes, në përmbijllje të arsyetimit të vendimit, duke kujdesur që, në rastet e kthimit të çështjes për rigjykim, të evidentohen qartë detyrat e lëna nga gjykata e apelit për tu zbatuar gjatë rigjykimit.

Në pjesën e dispozitivit gjen pasqyrim disponimi i gjykatës konform nenit 466 të K.Pr.Civile apo nenit 428 të K.Pr.Penale, si dhe data e shpalljes së vendimit. Nuk rezulton të jetë referuar e drejta e

ankimit ndaj vendimit. Në vendimet penale, në rastet e ndryshimit të tyre, gjyqtarja {...} evidenton pjesën e ndryshuar në raport me kualifikimin ligjor të faktit penal, masën e dënimit, uljen e tij sipas nenit 406 të K.Pr.P²⁵, po e njëjta gjë evidentohet edhe në vendimet civile²⁶

Vendimet gjyqësore përmbajnë të gjithë elementët e parashikuar në ligjin procedural, vendimet civile elementët e parashikuar në nenet 310 dhe 466 të K.Pr.Civile dhe vendimet penale elementët e parashikuar në nenin 383 të K.Pr.Penale. Vendimet janë të strukturuar në paragrafë të cilët përmbillen me fjali përmbledhëse në formën e konkluzionit, duke theksuar konkluzionin e arritur nga gjyqtarja, si pasojë logjike e arsytimit, për çdo pretendim të ngritur në ankim, në funksion të vendimmarrjes përfundimtare. Gjyqtarja {...} në të gjitha vendimet ndjek rregulla të qarta dhe përgjithësisht të njëjta në strukturimin e vendimit gjyqësor, duke zbatuar në çdo rast rregullat e shkrimit dhe arsytimit ligjor, përgjithësisht referuar metodës CRAC, duke identifikuar konkluzionin e gjykatës së apelit, faktet, provat, argumentimin ligjor në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm dhe konkluzionin e arritur.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar burimeve të vlerësimit për këtë tregues, evidentohet se gjyqtarja {...} ka aftësi shumë të larta në ndjekjen e një strukture të qëndrueshme të vendimit, ndjek rregullat e shkrimit dhe arsytimit ligjor dhe i kushton rëndësi evidentimit të fakteve të çështjes, analizës së tyre, aplikimit të ligjit mbi to dhe paraqitjen e konkluzioneve të arritura mbi bazën e kësaj analize.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, vlerësoj se shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “Struktura e qëndrueshme dhe e mirë organizuar e vendimit” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 10 pikë.

1.B.C. CILËSIA E ANALIZËS DHE ARGUMENTIT LOGJIK

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;

²⁵Vendimi nr. 72 date 26.01.2015; Vendimi nr. 1042 date 27.05.2015; Vendimi nr. 1023 date 22.05.2015.

²⁶Vendimi nr. 3539 date 27.10.2014; Vendimi nr. 103 date 27.01.2015; Vendimi nr. 1023 date 22.05.2015.

- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja dhe 1 vendim i administruar për shkak të ankesave);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se “*. Përmbajtja e vendimit përfundimtar është gjithëpërfshirëse dhe i jepet përgjigje pretendimeve të palëve. Në tekstet e vendimit ekziston lidhja midis fakteve dhe konkluzioneve që ka arritur gjyqtarja. Në nxjerrjen e konkluzioneve i kushton rëndësi analizës së normës ligjorë, e cila paraqitet e thjeshtë dhe e kuptueshme Gjykatësja, paraqet raste kur i referohet vendimeve Unifikues të Gjykatës së Larte. Kështu në dokumentin 2, dhe dosjen 3, ku janë gjykuar çështje penale, gjyqtarja në arsyetimin e vendimit i referohet vendimit Unifikues nr. 2 datë 29.01.2003, lidhur me kuptimin e gjykimit ë shkurtuar, në vlerësimin e provave. Gjykatësja i referohet dhe ligjeve te posaçme, kur konstaton se lidhet me objektin e gjykimit, konkretisht interpreton ligjin nr. 8975 date 21.11.2002, "Për trajtimin e faturës tatimore të ujit të pijshëm...", (shih dosja 1). Në gjykimin civil administrativ, i referohet ligjit 49/2012, "Për organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave Administrative në RSh", (shih dokumenti3).Niveli i arsyetimit te vendimeve te vëzhguara respekton standardin e procesit te rregullt ligjor. Në dispozitiv, në rastin e tre dokumenteve të zgjedhura nga gjyqtarja, paraqiten shpenzimet gjyqësorë, por nuk tregohet e drejta e paraqitjes së rekursit për palët. Ne rastet e tjera to vëzhguara, për pesë dosjet e zgjedhurar me short, është konstatuar se nuk disponohet për shpenzimet procedurale gjyqësore dhe për të drejtën e ankimit për palët, por gjithashtu nuk rezulton që të ketë patur pasoja për palët, lidhur me te drejtën për të paraqitur rekurs, kjo dhe për faktin se vendimet janë arsyetuar shpejt dhe janë dorëzuar në sekretari brenda afatit. Vendimet e ndërmjetme të përdorura gjatë gjykimit, kanë qenë të karakterit procedural, që lidhen me përfaqësimin, si dhe me vendim marrjen për vijimin e gjykimit, në rast të mungesës së palëve. Në këto raste nuk ka qene i nevojshëm arsyetimi i tyre, pasi kane qene ne zbatim të procesit te rregullt ligjor dhe këto vendime të ndërmjetme mund të ankimohen me vendimin përfundimtar”.*

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :

Në shumicën e vendimeve gjyqësore të analizuara, rezulton një nivel shumë i mirë arsyetimi, i plotë dhe i qartë, duke shqyrtuar dhe argumentuar çdo element të diskutueshëm në raport me faktin penal/civil objekt shqyrtimi, si dhe çdo element të vlerësuar të nevojshëm për t’u analizuar në raport me aspektet procedurale, si në rastet kur ai përbën shkak ankimi ashtu edhe në rastet kur analiza e fakteve dhe dispozitave me natyrë procedurale është thelbësore për zgjidhjen e çështjes. Gjyqtarja tregon kujdes në arsyetim për të identifikuar dhe analizuar konceptet ligjore në dobi të konkluzioneve të arritura lidhur me zgjidhjen e çështjes. Në çdo rast ka evidentuar në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme thelbin e konfliktit objekt gjykimi duke orientuar dhe analizën e koncepteve ligjore në shërbim të arritjes së konkluzioneve në lidhje me zgjidhjen e çështjes.

Arsyetimi i vendimeve është i qartë, i plotë dhe përgjithësisht merr në analizë dhe i jep përgjigje të gjitha pretendimeve dhe kërtimeve të palëve ndërgjyqëse, duke i analizuar ato me vetë në shumicën e vendimeve burim vlerësimi. Në disa vendime të cilat kanë të bëjnë me konflikte jo komplekse, analiza e shkaqeve të ankimit behët në tërësi në arsyetim, pa i veçuar ato nga njëri tjetri, por në çdo rast duke i dhënë përgjigje të argumentuar.

Në funksion të analizës ligjore dhe argumentit të përdorur drejt zgjidhjes së çështjes, gjyqtarja në arsyetim bën një analizë të provave mbi të cilat ai mbështetet, duke veçuar në disa raste pjesë të përmbajtjes së tyre që i shërbejnë provueshmërisë së fakteve objekt gjykimi siç janë pjesë nga përgjimet.²⁷

Në një pjesë të vendimeve burim vlerësimi, përveç analizës së provave dhe nxjerrjes së faktit juridik konkret, gjyqtarja i kushton rëndësi analizës së instituteve të caktuara të së drejtës, kur kjo rezulton e nevojshme p.sh.: Institutit të dënimit, apo edhe të alternativave të dënimit duke përcaktuar qëllimin, funksionin e tyre, si dhe kushtet dhe kriteret që duhet të përmbushen për zbatimin e tyre, duke i analizuar në mënyrë të detajuar këto kriteret në ligj në përputhje me provat dhe rrethanat në çdo rast gjykimi; institutin e bashkëpunimit

Në lidhje me marrjen në shqyrtim të pretendimeve të palëve, ato përveçse janë pasqyruar në pjesën hyrëse të vendimit, janë pjesë e integruar e vendimit gjyqësor, duke u pozicionuar në atë pjesë të arsyetimit me të cilën lidhet pretendimi i ngritur në ankim (*me provueshmërinë e faktit, cilësimin ligjor të faktit penal apo përcaktimin e natyrës së mosmarrëveshjes civile, etj.*).

Në të gjitha vendimet burim vlerësimi (civile/penale) rezulton se pretendimet e palëve gjithnjë kanë marrë një përgjigje të argumentuar dhe analizuar në aspektin e mbështetjes në ligj ose prova të tyre.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të lartë në treguesin “Cilësia e analizës dhe argumentit logjik”. Arsyetimi i vendimeve është i qartë, i plotë dhe përgjithësisht merr në analizë të gjitha pretendimet e ngritura nga palët në ankim, duke i dhënë përgjigje të argumentuar çdo pretendimi, si për çështje të procedurës, ashtu edhe për themelin e zgjidhjes së saj.

²⁷Vendimi nr.1023, datë 22.05.2015 i Gjykatës së Apelit Tiranë

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësoj se shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “Cilësia e analizës dhe argumentit logjik” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 25 pikë.

Niveli i vlerësimit dhe pikëzimi për kriterin e “Aftësive profesionale të gjyqtarës”

Niveli i vlerësimit	
KRITERI	
AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARES	
Niveli i vlerësimit	Pikët
Shkëlqyeshëm	100

2. AFTËSIA ORGANIZATIVE E GJYQTARES

Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtarës {...} në drejtim të aftësive organizative, vlerësuesi përqendrohet në aftësinë për të organizuar, menaxhuar dhe kontrolluar efektivisht procedurat gjyqësore. Produktiviteti është rrjedhojë e menaxhimit të kohës, i cili tregon sa mirë gjyqtarja përdor kohën e tij, si kur gjykon i vetëm, ashtu edhe në panel me të tjerë.

2.A. AFTËSIA PËR TË PËRBALLUAR NGARKESËN NË PUNË

2.A.A. RESPEKTIMI I AFATEVE LIGJORE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja dhe 1 vendim i administruar për shkak të ankesave);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, nuk ka të dhëna.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, lidhur me këtë tregues, rezulton se:

Në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtares, referuar formatit të statistikave të administruara për efekt të këtij procesi, të cilat shërbejnë si burim vlerësimi edhe në procedurën e gradimit, nuk ka të dhëna specifike për kohëzgjatjen e gjykimit për të gjitha çështjet. Për pasojë, vlerësimi lidhur me këtë tregues do të bëhet duke iu referuar 11 (njëmbëdhjetë) çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, 3 (tre) vendimeve të përzgjedhura nga gjyqtarja. Vendimi nr. 32 datë 20.03.2014 i Gjykatës së Apelit Tiranë i administruar për shkak të ankesave, nuk ka të dhëna specifike për kohëzgjatjen e gjykimit.

Nga vëzhgimi i 11 (njëmbëdhjetë) çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, 3 (tre) vendimeve të përzgjedhura nga gjyqtarja referuar kategorisë së çështjeve, rezulton se për vetëm për dy prej tyre parashikohet afat ligjor brenda të cilit duhet të përfundojë gjykimi i çështjes në Gjykatën Administrative të Apelit. Konkretisht kemi të bëjmë me:

- Vendimi 3 i zgjedhur nga gjyqtarja, që i përket vendimit me nr.103, datë 27.01.2015- *(është regjistruar në gjykatën Administrative të Apelit në datën 03.06.2014 dhe ka përfunduar në datën 27.01.2015.)* Gjykimi ka zgjatur 6 muaj e 24 ditë, duke përjashtuar muajin gusht ku gjykata dhe administrata gjyqësore janë pushim, ky gjykim konsiderohet i përfunduar jashtë afatit ligjor prej 30 ditësh, të parashikuar në nenin 48/2 të ligjit 49/2012, por në mungesë të dhënave mbi datën e vënies në lëvizje të çështjes nga ana gjyqtare për shqyrtimin e kësaj çështje si dhe të datës së caktimit të çështjes gjyqtare e cila në Gjykatën Administrative të Apelit ka qene e deleguar, në këto kushte ky vendim nuk mundet të merret si burim vlerësimi.

Ndërsa për çështjen e mëposhtme :

- Në çështjen civile me nr. 2869 regj, me palë paditëse Komuniteti Musliman i Shqipërisë, me objekt të padisë «Pavlefshmëri urdhri ekzekutimi...», rezulton se çështja është regjistruar në gjykatë në datë 15.01.2013 dhe me shortin elektronik të datës 02.07.2013 i është caktuar gjyqtare {...}. Nga aktet e dosjes (regjistri i njoftimeve) rezulton se ajo është vënë në lëvizje nga Kryetari i gjykatës së Apelit Tiranë duke planifikuar seancën e parë në datë 22.11.2013, dhe ka përfunduar në datë 22.11.2013. Gjykimi i kësaj çështje ka zgjatur 7 muaj e 10 ditë duke përjashtuar muajin gusht, duke e tejkaluar këtë afat prej 20 ditë të përcaktuar nga neni 610 i K.Pr.C. Duke patur parasysh se në nenin 460 të K.Pr.Civile, para ndryshimeve të këtij neni me ligjin nr. 38/2017, datë 30.3.2017, parashikohet se: “Gjykata e apelit e shqyrton çështjen në mënyrë kolegjiale. Ajo gjykon me trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë. Kryetari i gjykatës së apelit cakton relatorin e çështjes dhe ditën e gjykimit. Sekretaria e gjykatës së apelit i njofton palët rregullisht (nenet 128-133) të paktën 10 ditë më parë, ditën e shqyrtimit të çështjes në apel, si dhe shpall listën përkatëse të çështjeve. Çështja e mësipërme ka përfunduar brenda një seance të vetme dhe konsiderohet se është respektuar i afati ligjor prej 20 ditësh.”

KONKLUZIONI

Për pasojë, pavarësisht se të dhënat statistikore të administruara në dosje nuk japin informacion për kohëzgjatjen e të gjitha çështjeve për të cilat ligji parashikon afat gjykimi, duke iu referuar dy çështjeve të analizuara më sipër në të cilat parashikohet afat ligjor për përfundimin e tyre, si dhe ne mungesës së të dhënave të plota për vendimin e përzgjedhur nga gjyqtarja, vlerësoj se aftësia e gjyqtarës në lidhje me këtë tregues, duhet të pikëzohet në nivelin maksimal të tij.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “Respektimi i afateve ligjore”, gjyqtarja pikëzohet me 15 pikë.

2.A.B. PLOTËSIMI I STANDARDEVE MINIMALE KOHORE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja dhe vendimi i administruar për shkak të ankesave);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarës, referuar formatit të statistikave të administruara për efekt të këtij procesi, të cilat shërbejnë si burim vlerësimi edhe në procedurën e gradimit, nuk ka të dhëna specifike për kohëzgjatjen e gjykimit për të gjitha çështjet. Gjithashtu dhe për vendimin e administruar për shkak të ankesave nuk ka të dhëna specifike për kohëzgjatjen e gjykimit. Për pasojë, vlerësimi lidhur me këtë tregues do të bëhet duke iu referuar 11 (njëmbëdhjetë) çështjeve të përzgjedhura me short dhe 3 vendimeve të tjera të përzgjedhura nga gjyqtarja për të cilat ka të dhëna lidhur me datën e regjistrimit të çështjes.

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se “Nga analiza e 5 dosjeve të përzgjedhura me short për gjyqtaren {...}, rezultoi se nga dita e marrjes së akteve me short gjer në dhënien e vendimit ka qenë e ndryshme për çdo çështje. Kohëzgjatja më e shkurtër ka qenë 4 muaj dhe 2 ditë (shih dosjen nr. 5), ndërsa kohëzgjatja më e lartë ka qenë 11 muaj e 4 ditë (shih dosjen nr. 1). Në rastet e tjera gjykimet kane zgjatur 8 muaj e 10 ditë, 6 muaj, 8 muaj dhe 13 ditë. Sipas vendimit të KLD-së, me nr. 261/2 date 14.04.2010, "Sistemi i vlerësimit të gjyqtarëve",

Aneksi 1, pika 5 "Standardi kohor", pikës 5 shkronjat "g"; "h" dhe "j", rezulton se vetëm një çështje është përfunduar brenda afateve të përcaktuara në sistemin e vlerësimit, (shih dosja 3). Në katër rastet e tjera konstatohet se është tejkaluar afati standard i përcaktuar për gjykimet në shkallë të dytë sipas atij vendimi, por ky tejkalim ka një shkak të arsyeshëm.

Në rastin e çështjeve të paraqitura, dosjet 1, 2, 4, 5, tejkalimi i afatit të gjykimit, nuk është përgjegjësi e gjyqtarës, pasi në të gjitha rastet, ajo e ka përfunduar gjykimin brenda afateve ligjore, në dy raste me një seance të vetme. Vonesat kanë ardhur për shkak të përcaktimit të seancës së parë të gjykimit, pas një periudhe kohore që tejkalon afatet e gjykimit. Seanca e parë gjyqësore, është caktuar nga kryetari i gjykatës sipas nenit 460/2 të K.Pr.Civile, për çështjet civile dhe sipas nenit 426/1 të KPP, për çështjet penale. Prandaj nuk ka tejkalim të afatit nga ana e gjyqtarës, për të cilën të ketë përgjegjësi për tejkalimin e aftit.

Në 3 dokumentet e paraqitura nga vetë subjekti i rivlerësimit, është bere e mundur përcaktimi i afatit të gjykimit, nga të dhënat e vetë vendimit, pasi në vendim është paraqitur data e vendimit dhe data e regjistrimit të çështjes. Për këto vendime koha e gjykimeve ka qenë 11 muaj e 15 ditë (shih dokumentin nr. 1), 4 muaj dhe 27 dite (shih dokumentin nr. 2) dhe 7 muaj e 24 ditë (shih dokumentin nr. 3). Kjo e dhënë nuk tregon datën e marrjes së akteve me short nga gjyqtarja. Gjithashtu nuk ka të dhëna se kur është caktuar seanca e parë e gjykimit nga kryetari i gjykatës, me qëllim që të përcaktohet saktë afati i gjykimit, për të cilin ka përgjegjësi gjyqtarja”.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:

Për 10 nga 11 çështjet e vëzhguara për të cilat nuk parashikohet afat ligjor gjykimi, vendimit të administruar për shkak të ankesave dhe 2 nga vendimet e përzgjedhura nga gjyqtarja për vlerësim, gjykimi ka përfunduar brenda standardit minimal kohor sipas vendimit nr.261/2 të ish KLD.²⁸

Referuar 2 (dy) vendimeve të përzgjedhura nga vetë gjyqtarja, konstatohet se:

- I. Në çështjen civile nr. 5369/2657 regi, me palë paditëse M.L., me objekt “Detyrimin ete paditurit për të shlyer detyrimet që rrjedhin nga kontrata...”, sipas të dhënave në pjesën hyrëse të këtij vendimi rezulton se data e regjistrimit është 12.11.2013 dhe data e përfundimit të çështjes 27.10.2014, pra për një kohëzgjatje prej 11 muaj e 15 ditë, në tejkalim të standardit minimal kohor prej 6 muaj të parashikuar në vendimin nr. 261/2 të KLD. Në mungesë të dhënave mbi datën e vënies në lëvizje të çështjes dhe caktimit të seancës së parë gjyqësore nëpërmjet shpalljes së listave të gjykimit nga kryetari i Gjykatës në referim të parashikimeve të nenit 460/2 të Kodit të Procedurës Civile,²⁹ përlllogaritja e kohëzgjatjes së gjykimit në këtë

²⁸Në pikën 5 të Aneksit g dhe h të vendimit të KLD nr. 261/2, parashikohet se: “Standardi kohor i punës nënkupton realizimin nga gjyqtari të gjykimeve brenda një afati kohor maksimal nga data e caktimit të gjyqtarit të çështjes si me poshtë: a. Gjykimet penale në gjykatën e Apelit jo më tej se 2 muaj kur procedohet për kundërvajtje penale, jo më tej se 6 muaj kur procedohet për krime që dënohen në maksimum deri në 10 vjet burgim dhe jo më tej se 9 muaj kur procedohet për krime që dënohen në minimum jo më pak se 10 vjet burgim ose me burgim të përjetshëm.” Gjykimet civile në Gjykatën e Apelit jo më tej se 6 muaj”.

²⁹Në nenin 460 të K.Pr.Civile, para ndryshimeve të këtij neni me ligjin nr. 38/2017, datë 30.3.2017, parashikohet se: “Gjykata e apelit e shqyrton çështjen në mënyrë kolegjiale. Ajo gjykon me trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë. **Kryetari i gjykatës së apelit cakton relatorin e çështjes dhe ditën e gjykimit.**”

këndvështrim rezulton e pamundur dhe për pasojë, ky vendim nuk mund të shërbejë si burim vlerësimi për këtë tregues, pasi nuk ka të dhëna të mjaftueshme për të përcaktuar kohëzgjatjen e gjykimit dhe për pasojë, për të vlerësuar nëse ajo është përfunduar brenda apo jashtë afatit standard në fuqi.

- II. Në çështjen penale nr. 2498/1308 regj. ndaj të pandehurve R.B. dhe R.M., akuzuar për kryerjen e veprave penale të parashikuara nga neni 135 dhe 25 Kodit Penal, sipas të dhënave në pjesën hyrëse të këtij vendimi rezulton se data e regjistrimit është 25.11.2014 dhe data e përfundimit të çështjes 22.05.2015. Duke iu referuar datës së regjistrimit të çështjes,³⁰ kjo çështje ka përfunduar brenda një afati prej 4 muaj e 27 ditë, brenda standardit minimal kohor prej 6 muaj, referuar vendimit 261/2 të KLD, Aneksi 1 pika 5 germa “g”;

Referuar 10 (dhjetë) çështjeve të përzgjedhura me short, për të cilat nuk parashikohet afat ligjor gjykimi, konstatohet se:

- I. Në çështjen civile me nr. 3936/1485 regj. me palë paditëse Shoqëria CTH, me objekt të padisë «Deklarimin e detyrimit sipas titullit ekzekutiv», rezulton se çështja është regjistruar në gjykatë në datë 15.01.2013 dhe me shortin elektronik të datës 02.07.2013 i është caktuar gjyqtarës {...}. Nga aktet e dosjes (regjistri i njoftimeve) rezulton se ajo është vënë në lëvizje nga gjyqtarja në datë 03.07.2013, duke planifikuar seancën e parë në datë 23.05.2013, dhe ka përfunduar në datë 06.06.2014. Pra referuar të dhënave të sipërcituara rezulton se çështja ka përfunduar për 14 ditë nga data e nxjerrjes për gjyq, brenda afatit standard minimal kohor prej 6 muaj të parashikuar në vendimin nr. 261/2 të KLD.
- II. Çështja penale me nr. 2475/1285 regj. datë regjistrimi 21.11.2014, kategorisë penale themeli ka përfunduar me vendimin nr. 1042, datë 27.05.2015, për një kohëzgjatje prej 6 muaj, aq sa afatit standard minimal kohor prej 6 muaj të parashikuar në vendimin nr. 261/2 të KLD, duke u nisur nga data e regjistrimit të çështjes. Nga ana tjetër nëse do të niseshim nga data e akteve të njoftimit të administruara në dosje (në dosje nuk ka vendim për caktimin e seancës gjyqësore), rezulton se çështja është vënë në lëvizje me date 09.02.2015 duke caktuar seancën e parë gjyqësore në datë 25.03.2015, konstatohet se kjo çështje ka përfunduar për një afat prej 1 muaj e 15 ditë, brenda afatit standard minimal kohor prej 6 muajsh parashikuar në vendimin nr. 261/2 të KLD.
- III. Çështja penale me nr. 3421/1196 regj. datë regjistrimi 01.10.2015 e kategorisë penale themeli, ka përfunduar me vendimin nr. 1021, datë 20.07.2016, për një kohëzgjatje prej 8 muaj e 13 ditë, jashtë afatit standard minimal kohor prej 6 muaj të parashikuar në vendimin nr. 261/2 të KLD, duke u nisur nga data e regjistrimit të çështjes. Nga ana tjetër nëse do të niseshim nga data e akteve të njoftimit të administruara në dosje (në dosje nuk ka vendim për caktimin e seancës gjyqësore), rezulton se çështja është vënë në lëvizje çështjen në datë 13.06.2016, duke u caktuar seanca e parë gjyqësore në datë 20.07.2016, konstatohet se kjo çështje ka përfunduar për një afat prej 1 muaj e 7 ditë, brenda afatit standard minimal kohor prej 6 muajsh parashikuar në vendimin nr. 261/2 të KLD.

Sekretaria e gjykatës së apelit i njofton palët rregullisht (nenet 128-133) të paktën 10 ditë më parë, ditën e shqyrtimit të çështjes në apel, si dhe shpall listën përkatëse të çështjeve”.

³⁰Në mungesë të të dhënave të tjera në çështjet e përzgjedhura nga gjyqtari, për të cilat administrohen në dosje vetëm vendimet përfundimtare.

- IV. Çështja penale me nr. 2096/017 regj, datë regjistrimi 23.09.2014, e kategorisë penale themeli, ka përfunduar me vendimin nr. 72, datë 26.01.2015, për një kohëzgjatje prej 4 muaj e 2 ditë, brenda afatit standard minimal kohor prej 6 muaj të parashikuar në vendimin nr. 261/2 të KLD, duke u nisur nga data e regjistrimit të çështjes. Nga ana tjetër nëse do të niseshim nga data e akteve të njoftimit të administruara në dosje (në dosje nuk ka vendim për caktimin e seancës gjyqësore), rezulton se çështja është vënë në lëvizje në datë 04.11.2014, duke caktuar seancën e parë gjyqësore në datë 10.12.2014, konstatohet se kjo çështje ka përfunduar për një afat prej 2 muaj e 17 ditë, *brenda afatit standard minimal kohor prej 6 muajsh parashikuar në vendimin nr. 261/2 të KLD;*
- V. Në çështjen civile me nr. 4688/1996 regj, me palë paditëse F.M. objekt të padisë «Shpërblim demi», rezulton se çështja është regjistruar në gjykatë në datë 20.09.2013 dhe me shortin elektronik të datës 20.09.2013 i është caktuar gjyqtarës {...}. Nga aktet e dosjes nuk rezultojnë të dhëna për datën në të cilën dosja është vënë në lëvizje, por rezultojnë të dhëna vetëm për seancën e parë gjyqësore të planifikuar në datë 11.06.2014. Gjykimi ka përfunduar në datë 11.06.2014. Pra referuar të dhënave të sipërcituara rezulton se çështja ka përfunduar brenda ditës nga data e seancës së parë gjyqësore, *brenda afatit standard minimal kohor prej 6 muaj të parashikuar në vendimin nr. 261/2 të KLD;*
- VI. Në çështjen civile me nr. 3999 regj, me palë paditëse AMC objekt të padisë «Pagim shume», rezulton se çështja është regjistruar në gjykatë në datë 17.03.2014 dhe me shortin elektronik të datës 18.03.2014 i është caktuar gjyqtarës {...}. Çështja ka përfunduar për një kohëzgjatje prej 59 ditë, brenda afatit standard minimal kohor prej 6 muaj të parashikuar në vendimin nr. 261/2 të KLD, duke u nisur nga data e regjistrimit të çështjes. Nga aktet e dosjes nuk rezultojnë të dhëna për datën në të cilën dosja është vënë në lëvizje, por rezultojnë të dhëna vetëm për seancën e parë gjyqësore të planifikuar në datë 16.05.2014. Gjykimi ka përfunduar në datë 16.05.2014. Pra referuar të dhënave të sipërcituara rezulton se çështja ka përfunduar brenda ditës nga data e seancës së parë gjyqësore, *brenda afatit standard minimal kohor prej 6 muaj të parashikuar në vendimin nr. 261/2 të KLD;*
- VII. Çështja penale me nr. 2022 regj, datë regjistrimi 20.03.2015, e kategorisë penale themeli, ka përfunduar me vendimin nr.1949, datë 11.11.2015, për një kohëzgjatje prej 7 muaj e 25 ditë, jashtë afatit standard minimal kohor prej 6 muaj të parashikuar në vendimin nr. 261/2 të KLD, duke u nisur nga data e regjistrimit të çështjes. Nga ana tjetër nëse do të niseshim nga data e akteve të njoftimit të administruara në dosje (në dosje nuk ka vendim për caktimin e seancës gjyqësore), rezulton se çështja është vënë në lëvizje në datë 10.09.2015, duke caktuar seancën e parë gjyqësore në datë 10.12.2014, konstatohet se kjo çështje ka përfunduar për një afat prej 2 muaj e 3 ditë, *brenda afatit standard minimal kohor prej 6 muajsh parashikuar në vendimin nr. 261/2 të KLD;*
- VIII. Çështja penale me nr. 3161/977 regj, datë regjistrimi 06.10.2014, e kategorisë penale themeli, ka përfunduar me vendimin nr.15, datë 14.01.2015, për një kohëzgjatje prej 2 muaj e 19 ditë, brenda afatit standard minimal kohor prej 6 muaj të parashikuar në vendimin nr. 261/2 të KLD, duke u nisur nga data e regjistrimit të çështjes. Nga ana tjetër nëse do të niseshim nga data e akteve të njoftimit të administruara në dosje (në dosje nuk ka vendim për caktimin e seancës gjyqësore), rezulton se çështja është vënë në lëvizje në datë 29.12.2014, duke caktuar seancën e parë gjyqësore në datë

14.01.2014, konstatohet se kjo çështje ka përfunduar për një afat prej 14 ditë, brenda afatit standard minimal kohor prej 6 muajsh parashikuar në vendimin nr. 261/2 të KLD;

- IX. Çështja penale me nr. 2166 regj, datë regjistrimi 17.04.2015, e kategorisë penale (kundravajtje), ka përfunduar me vendimin nr.2224, datë 23.12.2015, për një kohëzgjatje prej 8 muaj e 11 ditë, jashtë afatit standard minimal kohor prej 2 muaj të parashikuar në vendimin nr. 261/2 të KLD, duke u nisur nga data e regjistrimit të çështjes. Nga ana tjetër nëse do të niseshim nga data e akteve të njoftimit të administruara në dosje (në dosje nuk ka vendim për caktimin e seancës gjyqësore), rezulton se çështja është vënë në lëvizje në datë 08.10.2015, duke caktuar seancën e parë gjyqësore në datë 09.11.2016, konstatohet se kjo çështje ka përfunduar për një afat prej 2 muaj e 16 ditë, jashtë afatit standard minimal kohor prej 2 muajsh parashikuar në vendimin nr. 261/2 të KLD për gjykimet penale (kundravajtje), me një tejkalim prej 16 ditësh;
- X. Çështja penale me nr. 2322/1135 regj, datë regjistrimi 28.10.2014, e kategorisë penale (kundravajtje), ka përfunduar me vendimin nr.195, datë 23.02.2015, për një kohëzgjatje prej 3 muaj e 20 ditë, jashtë afatit standard minimal kohor prej 2 muaj të parashikuar në vendimin nr. 261/2 të KLD, duke u nisur nga data e regjistrimit të çështjes. Nga ana tjetër nëse do të niseshim nga data e akteve të njoftimit të administruara në dosje (në dosje nuk ka vendim për caktimin e seancës gjyqësore), rezulton se çështja është vënë në lëvizje në datë 16.01.2015, duke caktuar seancën e parë gjyqësore në datë 23.02.2015, konstatohet se kjo çështje ka përfunduar për një afat prej 37 ditë, brenda afatit standard minimal kohor prej 2 muajsh parashikuar në vendimin nr. 261/2 të KLD për gjykimet penale (kundravajtje).

Referuar vendimit të administruar për shkak të ankesave, konstatohet se:

- XI. Në çështjen civile nr. 100/10 regj, me palë paditëse I.H., palë e paditur Ministria e Drejtësisë Tirane., etj., me objekt “Shfuqizim urdhri..”, sipas të dhënave në pjesën hyrëse të këtij vendimi nuk kemi të dhëna mbi datën e regjistrimit të çështjes por vetëm për datën e përfundimit 20.03.2013. Në mungesë të të dhënave mbi datën e regjistrimit dhe të vënies në lëvizje të çështjes dhe caktimit të seancës së parë gjyqësore nëpërmjet shpalljes së listave të gjykimit nga kryetari i Gjykatës në referim të parashikimeve të nenit 460/2 të Kodit të Procedurës Civile, përllogaritja e kohëzgjatjes së gjykimit në këtë këndvështrim rezulton e pamundur dhe për pasojë, ky vendim nuk mund të shërbejë si burim vlerësimi për këtë tregues, pasi nuk ka të dhëna të mjaftueshme për të përcaktuar kohëzgjatjen e gjykimit dhe për pasojë, për të vlerësuar nëse ajo është përfunduar brenda apo jashtë afatit standard në fuqi.

Nga burimet e vlerësimit, për disa nga çështjet e mësipërme, nuk ka informacion për datën e nxjerrjes për gjykim pasi në të gjitha dosjet nuk administrohet vendim për caktimin e seancës së parë gjyqësore apo njoftimet me shpallje publike, përveç çështjeve penale, ku si datë e tillë konsiderohet data e caktimit të seancës gjyqësore nga ana e gjyqtarës. Para ndryshimeve të K.Pr.Civile me ligjin 38/2017, nxjerrja e çështjeve civile për gjykim bëhej nga Kryetari i Gjykatës, i cili urdhëronte nxjerrjen e çështjeve për gjykim, nëpërmjet shpalljeve të afishuara në Gjykatën e

Apelit dhe gjykatat respektive të rretheve gjyqësore, nëpërmjet afishimit të shpalljeve, 3 javë para datës së seancës gjyqësore (neni 460 i K.Pr.Civile para ndryshimeve). Në këtë situatë, edhe nëse do të llogarisim përfshirjen e këtij afati 3/javor, në kohëzgjatjen e gjykimit të çështjeve si më lart, përsëri do të arrinim në të njëjtin konkluzion në lidhje me respektimin e standardit minimal kohor për të gjitha kategoritë e çështjeve, me përjashtim të vetme një çështje e konkretisht çështja penale me nr. 2166 regj, datë regjistrimi 17.04.2015, e kategorisë penale themeli, ka përfunduar me vendimin nr.2224, datë 23.12.2015, gjykimi i se cilës ka përfunduar për një afat prej 2 muaj e 16 ditë, jashtë afatit standard minimal kohor prej 2 muajsh parashikuar në vendimin nr. 261/2 të KLD për gjykimet penale (kundravajtje), me një tejkallim prej 16 ditësh.

Sa më sipër, referuar Metodologjisë të gjitha të dhënat statistikore analizohen sipas situatës, me qëllim për të shmangur përfundimet për çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarës. Analiza e të dhënave statistikore bazohet në kompleksitetin e çështjeve, volumin e çështjeve, rritjen e papritur të volumit të çështjeve, dhe aspekteve të tjera që lidhen me kushtet e punës, të cilat mund të çojnë në një pikëzim më të lartë nga ai i tabelës së mësipërme, deri në pikëzimin maksimal. Për rastin konkret duhet të marrim parasysh faktin që gjatë gjykimit janë zhvilluar katër seanca, por tre nga seancat kane qenë joproduktive për shkak se nuk konfirmohej marrja dijeni nga i pandehuri për të cilin njoftimi mbante shënimin “nuk gjendet” dhe dy seancat e tjera janë shtyrë për arsye se nga Drejtoria e Policisë Qarkut Tiranë nuk kthehej konfirmim zyrtar për njoftimin e të pandehurit. Seanca e katërt ka qenë seanca brenda së cilës është përfunduar gjykimi. Pra me gjithë masat e marra nga gjyqtarja për njoftimin e të pandehurit, shtyrja e seancave gjyqësore ka ndikuar në kohëzgjatjen e gjykimit dhe kjo ka të bëjë me shkaqe të pavarura nga gjyqtarja. Në këto kushte vlerësoj se nga ana e gjyqtarës janë respektuar standardet minimale kohore për të gjitha çështjet.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se standardi minimal kohor në fuqi është respektuar në të gjitha çështjet e analizuar dhe gjyqtarja {...} duhet të pikëzohet me 5 pikë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “respektimi i standardeve minimale kohore” gjyqtarja pikëzohet me 5 pikë, pasi përqindja e çështjeve të gjykuara prej saj tej standardit minimal, është 0-10%.

2.A.C. KOHA MESATARE QË I DEDIKOHET ÇDO ÇËSHTJEJE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (*5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja*);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (*6 dosjet e përzgjedhura me short*).

Në raportin analitik të rivlerësimit nuk ka konkluzion lidhur me këtë tregues.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit në lidhje me këtë tregues, rezulton se:

Në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtares, referuar formatit të statistikave të administruara për efekt të këtij procesi, nuk ka të dhëna specifike për kohëzgjatjen e gjykimit për secilën nga kategoritë e çështjeve që trajtohen në gjykata e apelit në periudhën e vlerësimit. Po ashtu, për 3 vendimet e përzgjedhura nga gjyqtarja për vlerësim dhe për vendimin e administruar për shkak të ankesave, sikurse u analizua në treguesin më sipër, nga të dhënat që rezultojnë nga dosja e rivlerësimit, nuk mund të përlllogaritet kohëzgjatja e gjykimit dhe për pasojë, rezulton e pamundur që këto 4 vendime të shërbejnë si burim për përlllogaritjen e kohës mesatare që i dedikohet çdo çështje.

Për pasojë, vlerësimi lidhur me këtë tregues, do të bëhet duke iu referuar 11 çështjeve të përzgjedhura me short për të cilat zbatohet standardi minimal kohor dhe jo afati ligjor i gjykimit.³¹Duke krahasuar kohën mesatare që i dedikohet çdo çështje, në raport me standardin minimal kohor për çdo kategori (*11 çështjet e marra në analizë janë 4 çështje civile dhe 7 çështje penale*), rezulton se:

- (i) Mesatarja e kohëzgjatjes së gjykimit për 6 çështjet në kategorinë e çështjeve “penale krime”, rezulton të jetë rreth 63 ditë ose 2 muaj dhe 3 ditë, ***pra më e shkurtër se standardi minimal kohor*** për gjykimin e çështjeve penale të themelit ne Gjykatën e Apelit.
- (ii) Mesatarja e kohëzgjatjes së gjykimit për 3 (tre) çështjet në kategorinë e çështjeve “civile themeli”, rezulton të jetë rreth 5.3 ditë, ***pra më e shkurtër se standardi minimal kohor*** prej 6 (gjashtë) muajsh për gjykimin e çështjeve civile të themelit ne Gjykatën e Apelit.
- (iii) Mesatarja e kohëzgjatjes së gjykimit për 2 (dy) çështje në kategorinë e çështjeve “Kundravajtje penale”, rezulton të jetë rreth 56.3, ***pra më e shkurtër se standardi minimal kohor*** prej 2 muajsh për gjykimin e çështjeve kundravajtje në Gjykatën e Apelit.

³¹ Në Metodologjinë e Pikëzimit, lidhur me këtë tregues, parashikohet se :” Në numrin total të çështjeve të gjykuara nuk përfshihen çështjet për të cilat parashikohen në ligj afate gjykimi.”.

Pra, kohëzgjatja mesatare e çështjeve të vëzhguara, është më e shkurtër se standardi minimal kohor për të gjitha çështjet e kësaj kategorie.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se koha mesatare që i dedikohet çdo çështje, për të gjitha kategoritë e çështjeve për të cilat zbatohet standardi minimal kohor si dhe ka të dhëna burimore, ka qenë më e shkurtër se standardi minimal kohor.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi:** Referuar sa më sipër, vlerësoj se në lidhje me treguesin “koha mesatare që i dedikohet çdo çështje” gjyqtarja duhet të pikëzohet me 5 pikë, pasi ajo është më e shkurtër se standardi minimal kohor.*

2.A.Ç. RENDIMENTI I PËRFUNDIMIT TË ÇËSHTJEVE GJYQËSORE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar.

Në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, është parashtruar se: *Subjekti rivlerësimit {...} në periudhën e rivlerësimit 08.10.2013 - 08.10.2016 ka kryer detyrën e gjyqtarës në Gjykatën e Apelit Tiranë, në seksionin civil dhe penal. Lidhur me ngarkesën e çështjeve, subjekti ka deklaruar se për periudhën 2014-2016, i janë caktuar për gjykim gjithsej 1337 çështje, ka përfunduar si relatore, 885 çështje dhe ka mbartur nga viti 2016, 8 çështje. Ndërsa çështje të mbartura në fund të vitit 2016 janë raportuar 19 çështje. Këto të dhëna i përkasin viteve të plota kalendarike 2014, 2015 dhe 2016, (rezulton se numri i çështjet e mbartura, nuk përputhen me shifrat e raportuara). Rendimenti i përfundimit të çështjeve, bazuar në këto të dhëna, është 66 %. Për të mbështetur këto të dhëna, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur provat shkresore: Shkresa e Gjykatës së Apelit Tirane nr. 217 date 19.01.2017, paraqit ngarkesa për tre vitet e fundit, gjithsej 1289 çështje, të ndara sipas viteve: 407 çështje në vitin 2014, 487 çështje në vitin 2015 dhe 395 çështje në vitin 2016. Shkresa e Gjykatës së Apelit Tiranë nr. 217/1 datë 19.01.2017, paraqit çështjet e gjykuara për tre vitet e fundit, gjithsej 885 çështje, të ndara sipas viteve: 299 çështje në vitin 2014, 265 çështje në vitin 2015 dhe 273 çështje në vitin 2016. Në*

vitin 2014, ka gjykuar dhe 47 çështje për Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, (ka një gabim aritmetik, pasi dalin 884 çështje). Shkresa e Gjykatës së Apelit Tiranë nr. 217/2 date 19.01.2017, paraqit çështjet e mbartura te gjyqtarës {...}, nga viti 2016 në vitin 2017, gjithsej 19 dosje.

Nga analiza e përmbajtjes së vërtetimeve konstatohet se nuk ka përputhje me të dhënat e deklaruara, për çështjet e mbartura, pasi janë deklaruar të mbartura çështjet për të cilat ishte caktuar data e gjykimit, kurse dosjet që i janë caktuar gjyqtarës me short, por që janë ne pritje të gjykimit, pra të caktimit të seancës së parë gjyqësore nuk janë raportuar.

Sipas të dhënave statistikore, të përcjella nga Gjykata e Apelit për efekt të organizimit të shortit në këtë gjykatë, konstatohet se për periudhën e rivlerësimit 08.10.2013 -08.10.2016, gjyqtarja {...} ka përfunduar 858 çështje, nga të cilat 550 penale dhe 308 çështje civile, (nga këto 301 civile të përgjithshme, 7 civile familjare). Gjatë vitit 2014, gjyqtarja {...}, ka gjykuar dhe 47 çështje, e deleguar pranë Gjykatës së Apelit Administrativ Tirane. Përfundimisht çështje të gjykuara, për periudhën e rivlerësimit janë 905 çështje. Në Sistemin e Vlerësimit, Aneksi 1, pika 3, "Standardi sasior", pikës 3, shkronja I), përcaktohet se gjyqtarja i gjykatës së apelit i dhomës civile, duhet të jete në cilësinë e relatorit në jo më pak se 200 gjykime çështjesh civile, brenda një viti kalendarik, ndërsa në shkronjën "h", se gjyqtarja i gjykatës së apelit i dhomës penalë, si relator jo më pak se 150 çështje penale. Duke qene se subjekti i rivlerësimit ka punuar si pranë dhomës civile dhe pranë dhomës penale, për afërsisht në raportin 50% me 50% të çështjeve, në këtë rast, kur çështjet janë të përziera, duke zbatuar këtë rregull nënkuptohet një ngarkese sasiore prej jo më pak se 525 gjykime çështjesh civile dhe penale, për periudhën prej tre vjetësh. Për gjyqtaren {...} konstatohet se ngarkesa e saj sasiore ka qenë mbi standardin sasior.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:

Referuar të dhënave të paraqitura në formularin e vetë deklarimit rezulton se gjyqtarës {...} i janë caktuar për gjykim 1337 çështje, për periudhën e vlerësimit nga të cilat ka përfunduar 858 çështje civile dhe penalë si dhe 47 çështje administrative si gjyqtare e deleguar pranë Gjykatës Administrative të Apelit që në total përbejnë 905 çështje të përfunduara. Nga ky raport rezulton se për gjyqtaren llogaritet një rendiment prej 67.8%.

Sipas të dhënave statistikore, të përcjella nga Gjykata e Apelit kemi të dhëna vetëm sa i takon totalit të çështjeve të përfunduara nga gjyqtarja {...}, nga përmbajtja e të cilave rezulton se gjyqtarja ka përfunduar 857 çështje. Si gjyqtare e deleguar pranë Gjykatës Administrative të Apelit ka përfunduar 47 çështje administrative.

Sa më sipër, duke konsideruar mungesën e të dhënave statistikore për numrin e çështjeve të caktuara për periudhën 3 vjeçare të vlerësimit tetor 2013-2016; përveçse të dhënat e deklaruar nga vete subjekti i vlerësimit, vlerësoj se do merret e mirëqenë për llogaritja e rendimentit në masën 67.8%, për qindje e cila sipas Metodologjisë përkon me vlerësimin me 2 pikë.

Në Metodologjinë e Pikëzimit, lidhur me këtë tregues, përcaktohet se: *“Të gjitha të dhënat statistikore analizohen sipas situatës, me qëllim për të shmangur përfundimet për çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarës. Analiza e të dhënave statistikore bazohet në kompleksitetin e çështjeve, volumin e çështjeve, rritjen e papritur të volumit të çështjeve, dhe aspekte të tjera që lidhen me kushtet e punës, të cilat mund të çojnë në një pikëzim më të lartë se ai i tabelës së mësipërme, deri në pikëzim maksimal, nëse gjyqtarja ka gjykuar brenda të njëjtit vit kalendarik më shumë se 50 % të standardit minimal të ngarkesës së përcaktuar nga Këshilli.”*

Për aspektin sasior sipas pikës 3, germa “h” të vendimit të ish KLD-së, nr. 261/2, datë 14.04.2010 “Sistemi i vlerësimit të gjyqtarëve” gjyqtarja e Gjykatës së Apelit që është organizuar në dhomë penale, duhet të jetë në cilësinë e relatorit në jo më pak se 150 çështjesh penale (krime e kundërvajtje), i llogaritur në periudhën 3 vjeçare jo me pak se 450 çështje penale dhe gjyqtarja i dhomës civile, duhet të jetë në cilësinë e relatorit në jo më pak se 200 çështje civile në vit, i llogaritur në periudhë 3 vjeçare, jo më pak se 600 çështje. Aneksi 1 i Sistemit të vlerësimit, në aspektin sasior nuk jep standarde minimale për gjyqtarjn e gjykatës së apelit që nuk është organizuar në seksione. Në këto kushte, për analogji, edhe me standardet minimale të përcaktuara për gjyqtarjen e shkallës së parë që nuk është organizuar në seksione, sipas përcaktimeve të Aneksit 1, do të merret si standard minimal 200 çështje themeli në vit (penale dhe civile).

Sa i përket standardit sasior, referuar të dhënave për numrin e çështjeve të përfunduara gjatë periudhës së vlerësimit, sipas të dhënave statistikore të administruara për efekte të organizimit të shortit gjatë procesit të rivlerësimit, ka rezultuar se gjyqtarja ka përfunduar rreth 700 çështje me palë kundërshtare, nga të cilat 653 (civile dhe penale themeli) si dhe 47 çështje si gjyqtare e deleguar në Gjykatën Administrative të Apelit duke përmbushur standardin sasior në fuqi, me 116 %.

KONKLUZIONI

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, për të vlerësuar këtë tregues, vlerësuesi nuk bën vetëm një veprim matematikor për të përcaktuar rendimentin e përfundimit të çështjeve, por ai bazohet edhe në kompleksitetin e çështjeve, rritjen e papritur të volumit të çështjeve apo aspekte të tjera që lidhen me kushtet e punës, të cilat mund të çojnë në një pikëzim më të lartë nga ai nivelit të përqindjes. Bazuar në këtë parashikim dhe në analizën statistikore si më sipër, rezulton se gjyqtarja {...} në periudhën 3 vjeçare të vlerësimit, ka përmbushur standardin minimal të ngarkesës duke e tejkaluar vetëm me 16.5%, por ajo çfarë duhet theksuar është se përqindja e çështjeve me palë kundërshtare të përfunduara nga gjyqtarja përben 77.3% të çështjeve në total të përfunduara. Bazuar në këtë parashikim, duke konsideruar (i) ngarkesën e përgjithshme në punë të gjyqtarës e cila rezulton të ketë përfunduar vetëm si relatore në total 905 çështje ose mesatarisht 301 çështje në vit; (ii) angazhimin e gjyqtarës në plotësimin e trupave gjykues në gjykatën e Apelit ku gjykimet zhvillohen

me trup gjykues me 3/gjyqtarë; (iii) faktin që nxjerrja e çështjeve civile për gjykim në periudhën e vlerësimit, 2013-2016 ka qenë atribut i Kryetarit të Gjykatës dhe nuk ishte në vullnetin e gjyqtarës ; (iv) angazhimin në gjykimin e 47 çështjeve si gjyqtare e deleguar në Gjykatën Administrative të Apelit, vlerësoj se për këtë tregues, niveli i pikëzimit që përcakton shkallën e aftësisë së gjyqtarës duhet të rritet me 2 shkallë, duke u pikëzuar me 6 pikë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në lidhje me këtë tregues, pavarësisht se rendimenti i përfundimit të çështjeve është 67.8 %, ky tregues duhet të pikëzohet me 6 pikë.

2.A.D. KOHA MESATARE E ARSYETIMIT TË VENDIMIT PËRFUNDIMTAR GJYQËSOR

Në lidhje me këtë tregues, në Metodologjinë e Pikëzimit parashikohet se ky është treguesi mesatar i kohës së arsyetimit të të gjitha vendimeve gjyqësore të dhëna nga gjyqtarja gjatë periudhës së vlerësimit, që llogaritet nga data e dhënies së vendimit, deri në datën e depozitimit në kryesekretari të vendimit të arsyetuar. Në vlerësimin për periudhën e vlerësimit 2013-2016, referuar të dhënave që ofrojnë tabelat me të dhëna statistikore të administruara në procesin e rivlerësimit, nuk jepen të dhëna për kohën e arsyetimit të të gjitha vendimeve gjyqësore, sipas kategorive. Për këtë arsye, ky tregues do të vlerësohet dhe pikëzohet duke iu referuar të dhënave për 11 çështjet e përzgjedhura me short për vlerësim.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit; (6 çështjet e përzgjedhura me short);
- Informacioni i përcjellë nga gjykata³² lidhur me afatin e dorëzimit të vendimit të arsyetuar.

Referuar raportit për analizimin e aftësive profesionale, të hartuar në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar, lidhur me kohën mesatare të arsyetimit të vendimit përfundimtar gjyqësor, konkludohet se “Lidhur me kohën mesatare të arsyetimit të vendimeve gjyqësore, nga vëzhgimet e 5 dosjeve të shortuara, rezultoi se gjyqtarja {...} i kushton rendësi te veçante arsyetimit ne kohe te shpejte te vendimeve gjyqësore. Arsyetimi i arsyetimi i vendimeve është kryer në interval kohor 4

³² Informacioni i dërguar nga Gjykata e Apelit Tiranë me shkresën nr.8939/3 Prot., datë 27.06.2023, protokolluar pranë KLGJ me nr. 3694 Prot. date 27.06.2023

ditë (dosja nr.1), për 10 ditë) dosja nr. 2), për 8 dite (dosja nr. 3), për 2 ditë (dosja me nr.4) dhe për 3 ditë (dosja me nr. 5). Të gjitha vendimet janë arsyetuar brenda afatit, pasi nuk konstatohet në asnjë rast të jetë tejkaluar afati 30 ditore...”

Në Kodin e Procedurës Penale në fuqi para ndryshimeve me Ligjin 35/2017, nuk ishte parashikuar sikundër sot, afat procedural për dorëzimin e vendimit të arsyetuar. Në praktikën gjyqësore kjo kohë gjithsesi nuk mund të ishte më e gjatë sesa afati i ankimit 30 (tridhjetë) ditor, sipas parashikimeve të nenit 435 pika 1 të K.Pr.Penale, në fuqi para ndryshimeve me ligjin nr. 35/2017, për shkak se e drejta e palëve për ushtrimin e rekursit ndaj vendimit penal të gjykatës së apelit, kur palët ishin prezent, fillonte nga e nesërmja e shpalljes së vendimit. Në këto kushte, në llogaritjen e afatit të dorëzimit të vendimit të arsyetuar, mbahet parasysh në rastin konkret, afati 30 ditor i rekursit ndaj vendimit penal të gjykatës së apelit.

Mbështetur në të njëjtin arsyetim, edhe për vendimet civile, K.Pr.Civile (para nëntorit 2017) nuk parashikonte afat procedural, por gjithsesi, ky afat nuk mund të ishte më i gjatë se afati për ushtrimin e të drejtës së rekursit sipas parashikimeve të nenit 443 paragrafi i dytë dhe nenit 476 të K.Pr.Civile.³³ Në këto kushte, në llogaritjen e afatit të dorëzimit të vendimit të arsyetuar, mbahet parasysh në rastin konkret, afati 30 ditor i rekursit ndaj vendimit penal dhe civil të gjykatës së apelit.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :

- Dosja 1, që i përket vendimit me nr.2500, datë 06.06.2014, është dorëzuar në datën 10.06.2014 - (4 ditë), brenda afatit 30 ditor për ushtrimin e rekursit, referuar edhe interpretimit të sipërcituar.
- Dosja 2, që i përket vendimit me nr.2541 datë 22.11.2013, është dorëzuar në datën 02.12.2013 - (10 ditë), brenda afatit 30 ditor për ushtrimin e rekursit, referuar edhe interpretimit të sipërcituar.
- Dosja 3, që i përket vendimit me nr.1042, datë 27.05.2015, është dorëzuar në datën 04.06.2015 - (8 ditë), brenda afatit 30 ditor për ushtrimin e rekursit, referuar edhe interpretimit të sipërcituar.
- Dosja 4, që i përket vendimit me nr.1021, datë 20.07.2016, është dorëzuar në datën 22.07.2016 - (2 ditë), brenda afatit 30 ditor për ushtrimin e rekursit, referuar edhe interpretimit të sipërcituar.
- Dosja 5, që i përket vendimit me nr.72, datë 26.01.2015, është dorëzuar në datën 29.01.2016 - (3 ditë), brenda afatit 30 ditor për ushtrimin e rekursit, referuar edhe interpretimit të sipërcituar.

Sipas informacionit të dërguar nga Gjykata e Apelit Tiranë me shkresën nr. nr.8939/3 Prot., datë 27.06.2023,protokolluar pranë KLGJ me nr. 3694 Prot. date 27.06.2023, lidhur me 6 (gjashtë) dosjet e përzgjedhura me shortin e datës 17.03.2022, rezulton se:

³³ Neni 476 paragrafi i parë i K.Pr.Civile parashikon se: “*Rekursi depozitohet në sekretarinë e gjykatës që ka dhënë vendimin, në afatin prej 30 ditësh nga njoftimi që u është bërë palëve*”. Në nenin 443 të K.Pr.Civile parashikohet se: “*Afati për të bërë kurs në Gjykatën e Lartë, kundër vendimeve të gjykatës së apelit, është 30 ditë*”.

- Dosja 6, që i përket vendimit me nr.2586 datë 11.06.2014, është dorëzuar në datën 17.06.2014 - (6 ditë), brenda afatit 30 ditor për ushtrimin e rekursit, referuar edhe interpretimit të sipërcituar.
- Dosja 7, që i përket vendimit me nr.2183, datë 16.05.2014, është dorëzuar në datën 21.05.2014 - (5 ditë), brenda afatit 30 ditor për ushtrimin e rekursit, referuar edhe interpretimit të sipërcituar.
- Dosja 8, që i përket vendimit me nr.1949, datë 11.11.2015, është dorëzuar në datën 13.11.2015 - (2 ditë), brenda afatit 30 ditor për ushtrimin e rekursit, referuar edhe interpretimit të sipërcituar.
- Dosja 9, që i përket vendimit me nr.15, datë 14.01.2015, është dorëzuar në datën 20.01.2015 - (6 ditë), brenda afatit 30 ditor për ushtrimin e rekursit, referuar edhe interpretimit të sipërcituar.
- Dosja 10, që i përket vendimit me nr.2224, datë 23.12.2015, është dorëzuar në datën 24.12.2015 - (1 ditë), brenda afatit 30 ditor për ushtrimin e rekursit, referuar edhe interpretimit të sipërcituar.
- Dosja 11, që i përket vendimit me nr.195, datë 23.02.2015, është dorëzuar në datën 05.03.2015 - (7 ditë), brenda afatit 30 ditor për ushtrimin e rekursit, referuar edhe interpretimit të sipërcituar.

Duke iu referuar kategorive të çështjeve objekt shqyrtimi, rezulton se koha mesatare e arsyetimit të vendimit

për kategorinë “*Penale krime*” është 4.2 ditë (*dosjet nr. 3,4,5,8,9*)

për kategorinë “*Civile themeli*”, është 6.25 ditë (*dosjet nr.1,2,6,7*)

për kategorinë “*Penale kundërvajtje*” është 3.5 ditë (*dosjet nr.10, 11*)

KONKLUZIONI

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar rezulton “Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve”.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “Koha mesatare e arsyetimit të vendimit gjyqësor përfundimtar” vlerësohet “Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve”, dhe pikezohet me 15 pikë.

2.B. AFTËSIA E GJYQTARES PËR TË KRYER PROCEDURAT GJYQËSORE

2.B.A. NUMRI MESATAR I SEANCAVE PËR ÇDO ÇËSHTJE DHE KRYERJA E VEPRIMEVE TË NEVOJSHME PROCEDURALE PËR SHMANGIEN E ATYRE JO-PRODUKTIVE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (*5 dosjet e përzgjedhura me short*);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (*6 çështjet e përzgjedhura me short*).

Në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, konkludohet se “ *Ndër 5 dosje të vëzhguara, rezulton se dy prej tyre kanë përfunduar me një seancë te vetme, (shih dosja 2, 4), dosjet e tjera kanë përfunduar ne 2- 4 seanca gjyqësorë, qe tregon se relatorja e ka njohur çështjen dhe i është përmbajtur kërkesave të ligjit.*”

Nga 11 çështjet e përzgjedhura për vlerësim, të gjitha vlerësohen si çështje me palë kundërshtare për efekt të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtares.

❖ Në pesë çështjet e përzgjedhura me short, administruar në dosjen e rivlerësimit konstatohet se:

- i. Dosja 1 – që i përket çështjes civile, me nr. 3936/1485 regjistri, datë regjistrimi 02.07.2013, të përfunduar me vendimin nr.2500, datë 06.06.2014, të Gjykatës së Apelit Tiranë, rezulton që për përfundimin e çështjes të jenë zhvilluar 2 seanca gjyqësore, nga të cilat 1 seanca kanë qenë joproductive, duke u shtyrë për shkak të mospajises me akt përfaqësimi te përfaqësuesit te palës paditëse.
- ii. Dosja 2 – që i përket çështjes civile, me nr. 2869 regjistri, datë regjistrimi 12.03.2013, të përfunduar me vendimin nr.2541, datë 22.11.2013, të Gjykatës së Apelit Tiranë, rezulton që për përfundimin e çështjes të jetë zhvilluar 1 seancë gjyqësore e cila ka rezultuar produktive, duke përfunduar me dhënien e vendimit përfundimtar.
- iii. Dosja 3 – që i përket çështjes penale, me nr. 2475/1285 regjistri, datë regjistrimi 21.11.2014, të përfunduar me vendimin nr.1042, datë 27.05.2015, të Gjykatës së Apelit Tiranë, rezulton që për përfundimin e çështjes janë zhvilluar 4 seancë gjyqësore, prej te cilave 3 seanca joproductive te shtyra për te realizuar njoftimin e te pandehurit dhe 1 seancë e cila ka rezultuar produktive, duke përfunduar me dhënien e vendimit përfundimtar.

- iv. Dosja 4 – që i përket çështjes penale, me nr.3421/1196 regjistri, datë regjistrimi 01.10.2015, të përfunduar me vendimin nr.1021, datë 20.07.2016, të Gjykatës së Apelit Tiranë, rezulton që për përfundimin e çështjes të jenë zhvilluar 1 seancë gjyqësore e cila ka rezultuar produktive, duke përfunduar me dhënien e vendimit përfundimtar.
- v. Dosja 5- që i përket çështjes penale, me nr. 2096/017 regjistri, datë regjistrimi 23.09.2014, të përfunduar me vendimin nr.72, datë 26.01.2015, të Gjykatës së Apelit Tiranë, rezulton që për përfundimin e çështjes të jenë zhvilluar 3 seanca gjyqësore e prej te cilave 2 seanca joproductive te shtyra për te realizuar njoftimin e te pandehurit dhe 1 seancë për shkak te mosparaqitjes se prokurorit dhe seanca e fundit e cila ka rezultuar produktive, duke përfunduar me dhënien e vendimit përfundimtar.

❖ Në çështjet e përzgjedhura me short, pas fillimit të procedurës së vlerësimit konstatohet se:

- vi. Dosja 6 – që i përket çështjes civile me nr.4688/1996 regjistri, datë regjistrimi 20.09.2013, të përfunduar me vendimin nr.2586, datë 11.06.2014, të Gjykatës së Apelit Tiranë, rezulton që për përfundimin e çështjes të jenë zhvilluar 1 seancë gjyqësore e cila ka rezultuar produktive, duke përfunduar me dhënien e vendimit përfundimtar.
- vii. Dosja 7 – që i përket çështjes civile, me nr.3999 regjistri, datë regjistrimi 17.03.2014, të përfunduar me vendimin nr.2183, datë 16.05.2014, të Gjykatës së Apelit Tiranë, rezulton që për përfundimin e çështjes të jenë zhvilluar 1 seancë gjyqësore e cila ka rezultuar produktive, duke përfunduar me dhënien e vendimit përfundimtar.
- viii. Dosja 8 – që i përket çështjes penale, me nr.2022 regjistri, datë regjistrimi 20.03.2015, të përfunduar me vendimin nr.1949, datë 11.11.2015, të Gjykatës së Apelit Tiranë, rezulton që për përfundimin e çështjes të jenë zhvilluar 3 seanca gjyqësore, dy nga të cilat ka rezultuar joproductive, për shkak të mosparaqitjes së të pandehurit me mjet identifikimi dhe një për mosparaqitjes të pandehurit seanca tjetër vijuese ka rezultuar produktive, duke përfunduar me dhënien e vendimit përfundimtar.
- ix. Dosja 9 – që i përket çështjes penale, me nr.3161/977 regjistri, datë regjistrimi 06.10.2014, të përfunduar me vendimin nr.15, datë 14.01.2015, të Gjykatës së Apelit Tiranë, rezulton që për përfundimin e çështjes të jenë zhvilluar 1 seancë gjyqësore e cila ka rezultuar produktive, duke përfunduar me dhënien e vendimit përfundimtar
- x. Dosja 10 – që i përket çështjes penale, me nr. 2166 regjistri, datë regjistrimi 17.04.2015, të përfunduar me vendimin nr.2224, datë 23.12.2015, të Gjykatës së Apelit Tiranë, rezulton që për përfundimin e çështjes është zhvilluar 4 seanca gjyqësore, 3 nga të cilat ka rezultuar joproductive, për njoftimin e të pandehurit qe nuk gjendej, seanca tjetër vijuese ka rezultuar produktive, duke përfunduar me dhënien e vendimit përfundimtar.
- xi. Dosja 11 – që i përket çështjes penale, me nr.2322/1135 regjistri, datë regjistrimi 28.10.2014, përfunduar me vendimin nr. 195, datë 23.02.2015, të Gjykatës së Apelit Tiranë, rezulton që për përfundimin e çështjes të jenë zhvilluar 1 seancë gjyqësore e cila ka rezultuar produktive, duke përfunduar me dhënien e vendimit përfundimtar

Nga tërësia e të dhënave të mësipërme, rezulton se numri i seancave gjyqësore të zhvilluara nga gjyqtarja në 11 çështjet e vëzhguara me palë kundërshtare (*penale themeli dhe civile themeli*) varion nga 1, deri në 4 seanca. Numri mesatar i seancave gjyqësore, duke iu referuar çështjeve të vëzhguara, rezulton sipas kategorive te jetë:

për kategorinë “*Penale krime*” është 2.4 seanca (dosjet nr. 3,4,5,8,9)

për kategorinë “*Civile themeli*”, është 1.2 (dosjet nr.1,2,6,7)

për kategorinë “*Penale kundërvajtje*” është 2.5 (dosjet nr.10, 11)

Sa i përket kryerjes së veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e seancave joproductive, nga vëzhgimi i 11 dosjeve të çështjeve me palë kundërshtare, rezulton se gjyqtarja ka kryer me korrektësi të gjitha veprimet procedurale për planifikimin dhe zhvillimin në kohë dhe me efektivitet të seancave gjyqësore, duke respektuar në çdo rast ligjin procedural (neni 460 të K.Pr.Civile dhe neni 426 dhe 342/2 të K.Pr.Penale). Gjyqtarja ka mbikëqyrur si duhet dërgimin pa vonesë të njoftimeve, njoftimet janë të plota dhe të qarta për palët që iu drejtohen, nuk konstatohet në asnjë rast mungesa e njoftimeve për palët në dosje dhe në çdo rast janë marrë masa efektive për të siguruar zhvillimin e seancave gjyqësore në kohë. Shtyrjet e seancave gjyqësore kanë ndodhur për shkaqe procedurale të tilla si: lënien kohe mbrojtësit të caktuar kryesisht për tu njohur me aktet e dosjes, me qëllim realizimin e një mbrojtje efektive, njoftimi i mbrojtësve, shpalljen e vendimit përfundimtar, etj. Në rastet e shtyrjes së seancave për shkaqe procedurale janë respektuar afatet ligjore për caktimin e seancës vijuese, sipas parashikimeve ligjore.

Referuar sa më sipër, për treguesin e “*Numrit mesatar të seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerjen e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre jo-productive*”, duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga vëzhgimi i 11 çështjeve me palë kundërshtare të përzgjedhura me short, rezulton se numri mesatar i seancave gjyqësore është 2 seanca, dhe po kështu gjyqtarja {...} në çdo rast ka treguar kujdes, duke marrë të gjitha masat e nevojshme procedurale për shmangien e seancave joproductive, planifikimin dhe zhvillimin e seancave në kohë dhe me efektivitet.

KONKLUZIONI

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, duke qenë se numri mesatar i seancave gjyqësore në dosje e analizuara është më i vogël se 3, si dhe shkalla e kujdesit të treguar nga gjyqtarja në shmangien e seancave joproductive dhe administrimin e procesit në tërësi është e lartë, vlerësoj se gjyqtarja {...} duhet të vlerësohet me 15 pikë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës për këtë tregues, vlerësohet “1-3 seanca dhe/ose shkallë shumë e lartë e aftësisë”, dhe pikëzohet me 15 pikë.

2.B.B. KRYERJA E VEPRIMEVE TË NEVOJSHME PROCEDURALE PËR ORGANIZIMIN E PROCESIT GJYQËSOR

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues konkludohet se: *“Subjekti i vlerësimit znj {...} ka aftësi për të kryer procedurat gjyqësore në funksion të zgjidhjeve të çështjeve. Numri i seancave gjyqësore rezulton se pesë prej dosjeve të vëzhguara, dy prej tyre kanë me një seancë, (shih dosja 2 4), ndërsa tre dosjet e tjera kanë përfunduar respektivisht me dy seanca, katër seanca, dhe tre seanca gjyqësore. Këto të rezultateve se janë vëzhguar gjithsej 11 seanca gjyqësore të kryhen, nga të cilat 5 seanca produktive dhe 6 seanca jo produktive. Rezulton seancat jo produktive janë shtyrë për arsye të ligjshme, që lidhen kryesisht me njoftimin e te njoftimin dhe pandehurve, për t'i dhënë për të marrë pjesë në gjykim. Gjyqtarja ka realizuar njoftimet në afat dhe ka dokumentuar kryerjen e veprimeve.*

Seancat janë zhvilluar në sistem audio ky është tregues i respektimit të solemnitetit gjyqësor dhe të bërjes transparente të çdo veprimi që ndodh gjatë gjyqësorit. Seancat janë zhvilluar në salla, duke e dokumentuar rregullisht këtë veprim. Vonesa në fillimin e seancave. Nga vëzhgimi i 5 dosjeve e është konstatuar se nuk ka vonesa në fillimin dhe seancave që i përkasin dosjet 2 dhe 4. Në tre dosjet e tjera, seancat kanë filluar me vonesë (shih dosjet nr. 1, 3, 5). Seancat për dosjen 1, ka filluar me 16 min. dhe 23 min. vonesë. Në dosjen 3, janë dy seanca që kanë filluar me vonesë, seanca e parë ka filluar me 40' vonesë, seanca e katërt ka filluar me 42' vonesë. Seancat e dosjes 5, kanë filluar të treja me vonesë respektivisht, me 1 orë e 13' vonesë, 2 orë dhe 26 min. vonesë dhe 1 orë e 19 min. me vonesë. Në këto raste nuk është relatuar shkak i vonesës, në proces verbalin e seancës gjyqësore. Megjithatë, në të katër rastet ku seanca ka filluar me vonesë, nuk ka patur rast që vonesa të jetë bërë shkak për shtyrjen e gjyqësorit. Efektiviteti i gjyqësorit rezulton i lartë. Subjekti është i qartë për rolin e Gjykatës së Apelit dhe kryen veprimet e nevojshme procedurale për zgjidhjen e pretendimeve të paraqitura në ankimmimin e palëve, duke qene i qartë në veprimet procedurale që realizon. Ndër 5 dosje të vëzhguara, rezulton se dy prej tyre kanë përfunduar me një seancë të vetme, (shih dosja 2, 4), dosjet e tjera kanë përfunduar në 2- 4 seanca gjyqësore, që tregon se relatori e ka njohur çështjen dhe i është përmbajtur kërkesave të ligjit....”

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :

Nga 11 çështjet e përzgjedhura me short për vlerësim, 7 prej tyre i përkasin kategorive të çështjeve penale me palë kundërshtare dhe 4 çështje i përket kategorisë së çështjeve civile me palë kundërshtare.

Gjyqtarja ka vënë në lëvizje çështjet (*konstatohet se në asnjë rast nuk është nxjerrë vendimi për caktimin e seancës*) për caktimin e seancës së parë gjyqësore, duke iu referuar rregullave dhe gjykimit të çështjeve në Apel, konform nenit 426 e vijues të K.Pr.Penale dhe 460 /2 të K.Pr.Civile. Seancat gjyqësore të zhvilluara në çështjet e vëzhguara janë dokumentuar në procesverbalin e seancës gjyqësore, janë mbajtur me regjistrim audio, si dhe janë dokumentuar me shkrim nga sekretarja gjyqësore.

Referuar burimeve të vlerësimit, evidentohet se përgjithësisht në çështjet e përzgjedhura me short, gjyqtarja {...} i ka vënë në lëvizje dosjet në kohë dhe në përputhje me kërkesat dhe afatet ligjore, duke caktuar seancën dhe duke kryer njoftimet përkatëse për palët.³⁴ Gjithashtu, rezulton se të gjitha veprimet procedurale gjatë shqyrtimit gjyqësor janë të dokumentuara. Drejtimi i procesit gjyqësor ka qenë i rregullt, sipas kërkesave procedurale të parashikuara në ligjin për gjykimin në apel (*neni 426/a i K.Pr.Penale dhe 464 të K.Pr.Civile*) kur është gjykuar si shkallë e dytë, mbi bazë ankimi. Gjatë zhvillimit të gjykimit, gjyqtarja tregon kujdes të posaçëm për verifikimin e paraqitjes së palëve, të mbrojtësve, relatimin e akteve të njoftimit të tyre, shkaqeve të mosparaqitjes së palëve ose pjesëmarrësve, marrjen e mendimit të palëve (*prokurorit apo paditësit/paditurit*) në çdo rast lidhur me ecurinë e gjykimit, zhvillimin e gjykimit në mungesë të të pandehurit/apo të palës së paditur, shpalljen e gjykatës, dëgjimin e kërkesave paraprake të palëve, shqyrtimin dhe vendimmarrjen e arsyetuar të gjykatës mbi këto kërkesa, zhvillimin e shqyrtimit gjyqësor sipas llojit të procesit të zhvilluar (*si shkallë e dytë*), dhënien e fjalës palëve mbi shkaqet e ankimit, shtyrjen e seancave gjyqësore, duke pasqyruar shkakun në çdo rast, si dhe urdhërimet për marrjen e masave për zhvillimin e seancës vijuese (*njoftimin e palëve, etj.*). Drejtimi i seancës zhvillohet në çdo rast nëpërmjet urdhrave dhe vendimeve të ndërmjetme, shoqëruar gjithmonë dhe me arsyet e vendimmarrjes.

Në dosjet e vëzhguara, seancat e planifikuara janë çelur relativisht në kohë, me vonesa nga 2 deri në 15 minuta, që janë të papërfillshme, e që lidhen me kushtet e punës dhe përgatitjen e sallës së gjykimit, në kushtet kur gjykimet zhvillohen njëri pas tjetrit, pa diferenca kohore. Megjithatë, konstatohet se disa seanca kanë filluar me më shumë se 26 minuta me vonesë, deri në 180 minuta me vonesë, nga ora e planifikuar, por në asnjë rast, fillimi me vonesë nuk ka sjellë joproduktivitetin e zhvillimit të seancës gjyqësore.

³⁴ Neni 426 i K.Pr.Penale; dhe 464 të K.Pr.Civile

KONKLUZIONI

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtarja {...} ka treguar shkallë shumë të lartë aftësie në këtë tregues, evidentuar në korrektësinë e planifikimit, mbikëqyrjes, zhvillimit dhe dokumentimit të veprimeve procedurale, duke respektuar standardet e procesit të rregullt ligjor dhe duke ndjekur me korrektësi hapat proceduralë të gjykimit penal, në seancat gjyqësore të zhvilluara.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi : Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “Kryerja e veprimeve procedurale për organizimin e procesit gjyqësor” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke u pikëzuar me 20 pikë.

2.C. AFTËSIA E GJYQTARES PËR TË ADMINISTRUAR DOSJEN GJYQËSORE

2.C.A. RREGULLSHMËRIA E DOKUMENTACIONIT TË DOSJES

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, konkludohet se “Nga vëzhgimi i 5 dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short, përgjithësisht nuk janë konstatuar mangësi në aftësitë për të administruar dosjet dhe për të mbikëqyrur saktësinë dhe plotësinë e akteve që përfshihen në të. Është konstatuar se aktet e hartuara nga gjykata janë të rregullta, të sakta dhe të plota .Procesverbali gjyqësorë dokumenton gjykatën, trupin gjykues, palët, objektin, kohën dhe vendin, si dhe veprimet që kryhen në seance, konform kërkesave të K.Pr.C dhe K.Pr.C. Vendimet e ndërmjetme fiksohen në procesverbalin e seancës gjyqësore”.

Aktet e dosjeve janë renditur në mënyrë të rregullt dhe duke ndjekur përgjithësisht të njëjtën radhë të renditjes së dokumenteve. Renditja e akteve është bërë duke ndjekur rendin logjik, sipas kategorive të akteve dhe rendin kronologjik (sipas datës së aktit) brenda së njëjtës kategori.

Renditja e akteve fillon me aktin procedural të shortit, vijon me njoftimet për palët në rend kronologjik, prapësimet dhe konkluzionet përfundimtare të palëve, procesverbalet e seancave sipas datave dhe mbyllet me vendimin gjyqësor përfundimtar.

Brenda kategorisë, aktet renditen sipas datave (*njoftimet, procesverbalet e seancave*). Renditja e akteve në dosje, e cila është përgjithësisht e njëjtë, është bërë në mënyrë të tillë që ta bëjë dosjen gjyqësore lehtësisht të shfrytëzueshme nga subjektet dhe nga gjykata më e lartë. Dosjet paraqiten të rregullta në aspektin formal të tyre, aktet janë të numëtuara dhe mund të shfrytëzohen me lehtësi.

KONKLUZIONI

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtarja {...} ka shkallë aftësie shumë të lartë në këtë tregues.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke u pikëzuar me 5 pikë.

2. C.B. SAKTËSIA DHE PLOTËSIA E DOKUMENTACIONIT TË DOSJES

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues konkludohet se: “Gjithashtu, tek 5 dosjet janë konstatuar edhe disa mangësi, që janë të njëjta, që tregon se bëhet fjalë edhe për metodologji pune. Relatimi i gjyqtarës për çështjen konkrete, bëhet në mënyrë verbale dhe përmbledhet me një frazë të përgjithshme në procesverbalin gjyqësor. Nuk dokumentohet shkak i fillimit me vonesë së seancës gjyqësore. Dosjet janë të inventarizuara rregullisht”.

Lidhur me saktësinë dhe plotësinë e dokumentacionit të dosjes rezulton se në dosjet gjyqësore të vëzhguara ndodhen të gjitha aktet e hartuara nga gjykata (*njoftimet për çdo veprim apo seancë, procesverbalet e çdo seance, vendimet gjyqësore*) si dhe aktet e paraqitura nga palët (*diskutimet përfundimtare të palëve etj.*). Nuk konstatohet mungesa të dokumentacionit në dosjet e vëzhguara (*me përjashtim të vendimit për nxjerrjen e çështjes në seancë gjyqësore*) apo prania e akteve apo dokumenteve që nuk i përkasin çështjes konkrete.

Neni 426, pika 1³⁵ i K.Pr.Penale, parashikon si kompetence të gjyqtarës kryesues urdhërimin për thirrjen e palëve, por nuk përcakton mënyrën e dokumentimit të këtij urdhërimi nëpërmjet një akti formal (*urdhër, vendim*) apo nëpërmjet njoftimeve. Pavarësisht mungesës së aktit formal në dosje, rezulton se kjo nuk ka sjellë pasoja në zhvillimin e gjykimit, pasi urdhërimi për thirrjen e palëve në seancën e parë gjyqësore, është dokumentuar dhe realizuar nëpërmjet akteve të njoftimit.

KONKLUZIONI

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë aftësie në këtë tregues, pasi pavarësisht se mungojnë vendimet e nxjerrjes së çështjes në gjykim, kjo mungesë nuk ka sjellë asnjë pasojë procedurale në zhvillimin e çështjes dhe përfundimin e saj, pasi disponimi i gjyqtarës për nxjerrjen e çështjeve për gjykim është bërë nëpërmjet urdhërimit për marrjen e masave nga sekretarja gjyqësore për njoftimin e palëve për seancën e parë gjyqësore.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 10 pikë.

Niveli i vlerësimit dhe pikëzimi për kriterin e “Aftësive organizative të gjyqtarës”

Niveli i vlerësimit	
KRITERI	
AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARËS	
Niveli i vlerësimit	Pikët

³⁵ Neni 426, pika 1 i K.Pr.Penale, **para ndryshimeve** me ligjin nr. 37/2017, parashikonte : “1. Kryetari i kolegjit të gjykatës së apelit urdhëron thirrjen e të pandehurit, paditësit civil dhe të paditurit civil, si dhe të mbrojtësve e të përfaqësuesve të tyre. Afati i paraqitjes nuk mund të jetë më i vogël se dhjetë ditë”.

Shkëlqyeshëm	100
--------------	-----

3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE

Vlerësimi i kriterit të etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale bëhet duke u bazuar në parimin kushtetues që çdo gjyqtar, për shkak të statusit të tij, ka etikë, integritet dhe shfaq paanësi në funksion. Pikëzimi për treguesit e këtij kriteri bëhet në rend zbritës, dhe çdo gjyqtar e fillon procesin e vlerësimit me totalin e pikëve referuar këtij kriteri vlerësimi, duke zbritur sipas rastit pikët në varësi të problematikave të shfaqura në lidhje me çdo tregues sipas burimeve të vlerësimit.

3.A. ETIKA NË PUNË

Lidhur me këtë kriter në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar rezulton se: *“Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave dhe i procedimeve disiplinore , nuk konstatohen të dhëna negative për etiken në punë të gjyqtarës {...} . Edhe nga vëzhgimi i 5 dosjeve nuk rezultuan të dhëna negative për këtë aspekt.”*

3.A.A. ANGAZHIMI DHE PËRGJEGJSHMËRIA NË FUNKSION

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Të dhënat nga burime arkivore të KLGJ/KLD;
- Të dhënat për masa disiplinore;
- Rezultatet e verifikimit të ankesave.

Referuar shkresës me nr. 1203/2 date 15.03.2019 i KLGJ-se nga përmbajtja e saj rezulton se: *“Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave, rezulton se gjatë periudhës trevjeçare të rivlerësimit “8 tetor 2013-8 tetor 2016”, për gjyqtaren {...} është paraqitur vetëm një ankesë në vitin 2014 në Ish KLD e cila me pas është arkivuar pas shqyrtimit fillestar me arsyetimin se është tej afatit pesë vjeçar”.*

Ndërkohë, në procesin e rivlerësimit kalimtar, lidhur me denoncimet nga publiku, referuar vendimit nr. 269 datë 01.07.2020 të KPK-së për subjektin e vlerësimit janë administruar 34 denoncime pranë KPK-së , dhe pas analizimit të dokumentacionit të administruar për shkak të këtyre denoncimeve, rezulton se nuk paraqiten shkaqe apo rrethana për të treguar veprime të njëanshme apo korruptive nga ana e subjektit të vlerësimit. Ndërsa referuar vendimit nr.36 datë 30.09.2022 të KPA, rezulton se për subjektin e rivlerësimit {...}, trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, me vendim të ndërmjetëm, ka vendosur të mos çelë hetimin. Shumica e trupit gjykues çmoi që denoncimet nuk

përmbajnë fakte, rrethana dhe të dhëna që përmbushin kërkesat e përcaktuara në nenin 53 të ligjit nr. 84/2016.

Në dosjen e dërguar nga organet e rivlerësimit, e cila përmban aktet e vlerësimit profesional të gjyqtarës {...} rezultojnë të jenë administruar 1 vendim gjyqësor, i cili shtrihet në periudhën e vlerësimit 2013-2016 konkretisht vendimi me nr. 32 datë 20.03.2013, i Gjykatës së Apelit Tiranë, me objekt “*Shfuqizim urdhri*”. Gjithashtu janë administruar edhe vendime të tjera por që nuk i përkasin periudhës së vlerësimit Tetor 2013-Tetor 2016 por i përkasin vitit 2018-2019-2020³⁶.

Në tërësi, nuk rezultojnë të dhëna për cenim të etikës apo elementë të tjerë që ndikojnë në vlerësimin e gjyqtarës.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezultojnë se gjyqtarja reflekton angazhim dhe përgjegjshmëri në funksion dhe nuk rezultojnë asnjë sjellje që mund të cenojë etikën në punë të tij. Për këto arsye, për këtë tregues rezultojnë se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të etikës në punë.

Shkalla e etikës në punë të gjyqtarës dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e etikës së gjyqtarës në treguesin “Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 35 pikë.

3.B. INTEGRITETI I GJYQTARES

Lidhur me këtë nënkriter, në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, konkludohet se: “*Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit {...} dhe nga 5 dosjet e vëzhguara konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm*”.

3.B.A. SHMANGIA E SHFAQJES SË PAHIJSHME, NDERI DHE DINJITETI

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

³⁶ vendimi nr. 1425 datë 16.10.2017; vendimi nr. 1370 datë 21.05.2018; vendimi nr. 1971 datë 12.09.2018; vendimi nr. 934 datë 03.07.2019; vendimi nr. 19 datë 20.01.2020;.

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Të dhënat nga burime arkivore të KLGJ/KLD;
- Të dhënat për masa disiplinore;
- Rezultatet e verifikimit të ankesave;
- Konkluzionet e raportit të ILDKPKI pasqyruar në vendimin e formës së prerë të organeve të rivlerësimit dhe konkluzionet e arritura në vendimin e formës së prerë të organeve të rivlerësimit lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë.

Referuar të dhënave nga burimet arkivore të KLD dhe dokumentacionit të administruar në dosjen e rivlerësimit, rezulton se për gjyqtaren {...} në periudhën e vlerësimit 2013-2016, nuk rezulton të jenë marrë ose zbatuar masa disiplinore.

Lidhur me rezultatet e trajtimit të ankesave, nuk rezulton asnjë e dhënë që të dëshmojë shfaqjen e sjelljeve që tregojnë mungesë integriteti të gjyqtares, shfaqje të pahijshme, shfaqje që cenojnë nderin, dinjitetin dhe pritshmërinë e publikut.

Rezulton se gjatë periudhës tre vjeçare të rivlerësimit 2013- 2016, për gjyqtaren rezulton vetëm një ankese viti 2014 në Inspektoratin e KLD, të cila është trajtuar, dhe arkivuar, sipas argumenteve të analizuara më sipër në këtë projektraport. Në materialin për verifikimin e ankesës rezulton se nuk janë konstatuar të dhëna që të dëshmojë shfaqjen e sjelljeve që tregojnë mungesë integriteti të gjyqtares, shfaqje të pahijshme, shfaqje që cenojnë nderin, dinjitetin dhe pritshmërinë e publikut.

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, me vendimin nr. 269, datë 01.07.2020, pasi ka parashtruar dhe analizuar burimet e vlerësimit në lidhje me aftësitë profesionale të gjyqtares, etikën, kriterin e vlerësimit të figurës dhe pasurisë, ka konkluduar si vijon: *“...Trupi Gjykuesi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, u njoh me rrethanat e çështjes dhe rezultatet e hetimit për komponentin e pasurisë, figurës dhe aftësive profesionale si dhe nuk evidentoi asnjë arsye në komponentin e figurës që do të shërbente për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit. Subjekti ka bashkëpunuar plotësisht me Komisionin në lidhje me të gjitha aspektet e hetimit, ajo ka dhënë informacion të plotë në lidhje me të ardhurat, pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme si dhe pozicionin e saj financiar dhe të anëtarëve të familjes. Në karrierën e saj gjyqësore ajo ka treguar njohuri të mjaftueshme ligjore në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit, arsyetim ligjor, ka aftësi organizative, si dhe etikë e profesionalizëm në punë për të vazhduar ushtrimin e detyrës. Në përfundim, trupi gjykues, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, pasi dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha shpjegimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, konkludoi se:*

- Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, znj. {...}, ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të gurmës “a”, të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016
- Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, znj. {...}, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të gurmës “b”, të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

Vendimi nr. 36, datë 30.09.2022 i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në të cilin, lidhur me kriterin e pasurisë për të cilin konsistonin shkaqet e ankimit, ka konkluduar se: *“Ne përmbledhje të sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se subjekti i rivlerësimit, znj. {...}, ka arritur nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë, nivel të besueshëm të kontrollit të figurës, si dhe një nivel të mirë kualifikues të vlerësimit të aftësive profesionale, sipas përcaktimeve të nenit 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016. Për këto arsye, vendimi nr. 269, datë 01.07.2020, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i cili ka vendosur konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. {...}, duhet të lihet në fuqi.”*

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit, nuk rezulton asnjë e dhënë apo element që të dëshmojë shfaqje të pahijshme apo cenim të nderit dhe dinjitetit të gjyqtarës.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja gëzon integritet të lartë. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtarja {...} ka shkallë shumë të lartë të integritetit, si dhe nuk rezulton asnjë e dhënë për sjellje të pahijshme, apo sjellje që cenojnë nderin dhe dinjitetin e saj.

***Shkalla e integritetit të gjyqtarës dhe pikëzimi:** Referuar sa më sipër, shkalla e integritetit të gjyqtarës në treguesin “Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 40 pikë.*

3.C PAANËSIA E GJYQTARES

Lidhur me këtë nënkriter në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, konkludohet se : *“ Nga 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga vete subjekti dhe nga 5 dosjet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit {...}. Për vetë gjyqtaren {...}, në asnjë prej 5 dosjeve të vëzhguara nuk ka patur kërkesa për përjashtimin e saj nga gjykimi i çështjeve. Nga ana tjetër, asnjë prej 3 dokumenteve ligjore dhe 5 dosjeve të vëzhguara nuk lidhen me çështje të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore apo të pakicave”.*

3.C.A. PËRDORIMI OSE JO I GJUHËS DISKRIMINUESE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruar gjatë procesit të rivlerësimit (*5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja, dhe vendimet të administruar për shkak të ankesave*);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit, duke përfshirë dhe regjistrimet audio të seancave (*6 dosjet e përzgjedhur me short*).

Referuar 3 vendimeve gjyqësore të dorëzuara nga gjyqtarja, dhe akteve të 11 çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, dhe vendimit të administruar nga organet e rivlerësimit kalimtare nuk rezulton në asnjë rast përdorimi i gjuhës diskriminuese nga gjyqtarja në komunikimin me palët ndërgjyqëse gjatë zhvillimit të seancave, apo në përmbajtje të vendimeve përfundimtare të tij. Gjithashtu, nuk ka asnjë të dhënë për përdorim të gjuhës diskriminuese me të tretët, referuar komunikimit shkresor dhe akteve përkatëse, të administruara në dosjet e gjykimit.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit nuk rezulton asnjë e dhënë për përdorim të gjuhës diskriminuese nga ana e gjyqtarës {...}.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja në asnjë rast nuk ka përdorur gjuhë diskriminuese, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, në komunikimin me subjektet e procedimit ose në përmbajtjen e vendimeve të hartuara prej saj. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtarja {...} ka shkallë shumë të lartë të aftësisë për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi:** Referuar sa më sipër, aftësia e gjyqtarës në treguesin “Shmangia e përdorimit të gjuhës diskriminuese” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 10 pikë.*

3.C.B NUMRI TEJET I LARTË I KËRKESAVE TË PRANUARA TË PALËVE PËR PËRJASHTIMIN E GJYQTARES

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Të dhënat statistikore.

Nga analiza e burimeve të vlerësimi lidhur me këtë tregues, rezulton se :

Referuar të dhënave statistikore të administruara në dosjen e rivlerësimit, nuk rezultojnë të dhëna për numrin e kërkesave për përjashtim apo numrin e kërkesave për heqje dorë të gjyqtares {...}, pasi kjo e dhënë nuk është kërkuar në formatin standard mbi të cilin janë raportuar të dhënat statistikore. Nga burimet e tjera (burimet arkivore të KLD/KLGJ) si dhe tërësia e akteve të administruara në dosjen e vlerësimit, nuk ka të dhëna për ekzistencën e një numri tejet të lartë të kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtares në periudhën e vlerësimit. Duke iu referuar tërësisë së akteve të administruara në dosjen e vlerësimit nuk rezultojnë të dhëna që në këto çështje të jenë paraqitur kërkesa për përjashtimin e gjyqtares {...}.

Në këto kushte, duke referuar në parimin kushtetues që çdo gjyqtar, për shkak të statusit të tij, është dhe duhet të shfaqë paanësi në funksion, në mungesë të të dhënave burimore për ekzistencën e një numri tejet të lartë të kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtares, në kushtet kur në rastet e gradimit zbatohen për aq sa është e mundur dispozitat e Ligjit për Statusin, vlerësoj se numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtares është i pakonsiderueshëm.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se nuk ka asnjë të dhënë për ekzistencën e një numri tejet të lartë të kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtares. Prandaj, për këtë tregues vlerësoj se numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtares, duhet të vlerësohet si i pakonsiderueshëm.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi:** Referuar sa më sipër, në treguesin “Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtares” vlerësohet “I pakonsiderueshëm”, duke e pikëzuar me 15 pikë.*

Niveli i vlerësimit dhe pikëzimi për kriterin “Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale”

Niveli i vlerësimit	
KRITERI	
ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE	
Niveli i vlerësimit	Pikët

Shkëlqyeshëm	100
--------------	-----

4. AFTËSIA PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL

Në këtë kriter vlerësohet kapaciteti personal dhe angazhimi profesional i gjyqtares në drejtim të aftësive të komunikimit, bashkëpunimit dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale.

4.A AFTËSIA E KOMUNIKIMIT

Lidhur me këtë nënkriter në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, konkludohet se *“Në 5 dosjet gjyqësore të vëzhguara, në procesverbalin gjyqësor në format letër, është konstatuar se komunikimi ka qenë i qartë dhe i rregullt. Gjuha, e përdorur në seancë gjyqësore dhe në akte tek 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara, është normale, komunikimi në përputhje me etikën gjyqësore dhe i qartë”.*

4.A.A. KOMUNIKIMI I QARTË DHE TRANSPARENT

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjor të administruar gjatë procesit të rivlerësimit;
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhur me short).

Referuar 3 vendimeve gjyqësore të përzgjedhura nga gjyqtarja për vlerësim, 1 vendimi të administruar për shkak të ankesave dhe akteve të 11 çështjeve të përzgjedhura me short (*kryesisht procesverbaleve të seancave dhe vendimeve gjyqësore*) rezulton se gjyqtarja gjatë komunikimit me palët dhe pjesëmarrësit në proces është e qartë, transparente, e kuptueshme. Vërehet se komunikimi i gjyqtares është i drejtpërdrejtë dhe konkret, në lidhje me çështjen për të cilën pyeten palët ose përfaqësuesit e tyre.

Gjithashtu, evidentohet komunikim i qartë, i saktë dhe konciz gjatë zhvillimit të seancave gjyqësore, duke e bërë procesin të kuptueshëm për palët dhe për pjesëmarrësit në të. Të njëjtat cilësi rezultojnë edhe në arsyetimin e vendimeve përfundimtare, ku gjuha e përdorur është e thjeshtë, e kuptueshme, e qartë, koncize dhe drejtpërdrejtë.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka komunikim të qartë dhe transparent me pjesëmarrësit në gjykim, si dhe në gjuhën e përdorur në arsyetimin e vendimeve.

Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër shkalla e aftësisë së gjyqtares në treguesin “Komunikimi i qartë dhe transparent” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 25 pikë.

4.A.B. RESPEKTIMI I KONFIDENCIALITETIT DHE MBROJTJES SË TË DHËNAVE PERSONALE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruar gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja dhe vendimit të administruar për shkak të ankesave);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhur me short).

Referuar 3 vendimeve gjyqësore të përzgjedhura nga gjyqtarja për vlerësim, dhe akteve të 11 çështjeve të përzgjedhura me short, nuk rezulton asnjë e dhënë për cenim të konfidencialitetit apo të të dhënave personale të subjekteve të procedimit.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues nuk rezulton asnjë e dhënë për mosrespektim të konfidencialitetit apo të dhënave personale dhe për rrjedhojë, prezumohet se gjyqtarja ka treguar kujdes maksimal për ruajtjen e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale të palëve apo subjekteve të procedimit, për të cilat ka ardhur në dijeni për shkak të funksionit.

Respektimi i konfidencialitetit nga gjyqtarja dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale” vlerësohet “E lartë”, duke e pikëzuar me 15 pikë.

4.B. AFTËSIA PËR TË BASHKËPUNUAR

Lidhur me këtë nënkriter në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, konkludohet se “Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara nuk janë konstatuar të dhëna specifike mbi aftësinë e subjektit {...} për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën gjyqësore. ”

4.B.A. SHKALLA E KOMUNIKIMIT DHE BASHKËPUNIMIT ME KOLEGËT, DUKE PËRFSHIRË SHKËMBIMIN E NJOHURIVE DHE PËRVOJËS PROFESIONALE ME TA

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Të dhënat për verifikimin e ankesave të paraqitura ndaj gjyqtarës gjatë periudhës së vlerësimit.

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, si burime vlerësimi për këtë tregues, veç të dhënave për verifikimin e ankesave, shërbejnë edhe vetëvlerësimi i gjyqtarës dhe mendimi i kryetarit.

Në rastin konkret, në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarës (gradimin), dy nga burimet e vlerësimit për këtë tregues mungojnë. Për pasojë, vlerësimi dhe pikëzimi për këtë kriter do të bëhet duke iu referuar dy burimeve të tjera, si dhe prezumimit se mungesa e ankesave apo të dhënave për mungesë të bashkëpunimit me kolegët, për rrjedhojë, prezumohet se ky komunikim është në nivel të lartë.

Nga të dhënat mbi verifikimin e ankesave, nuk rezulton asnjë e dhënë ose indicie për mungesë të bashkëpunimit të gjyqtarës me kolegët, gjatë periudhës së vlerësimit. Për pasojë, në mungesë të të dhënave që mund të rezultonin nga dy burimet e tjera të vlerësimit dhe mungesës të ndonjë të dhënë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë për mungesën e bashkëpunimit të gjyqtarës me kolegët, prezumohet se ky bashkëpunim ekziston dhe është në nivel shumë të lartë.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, dhe mungesës të dhënave për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit të gjyqtares me kolegët, prezumohet se gjyqtarja {...} ka shkallë shumë të lartë të komunikimit dhe bashkëpunimit me ta.

Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër shkalla e aftësisë së gjyqtares në treguesin “Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 15 pikë.

4.B.B. SHKALLA E KOMUNIKIMIT DHE BASHKËPUNIMIT ME ADMINISTRATËN GJYQËSORE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Të dhënat për verifikimin e ankesave të paraqitura ndaj gjyqtares gjatë periudhës së vlerësimit.

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, si burim vlerësimi për këtë tregues, veç të dhënave për verifikimin e ankesave, është dhe vetëvlerësimi i gjyqtares dhe mendimi i kryetarit. Në rastin konkret, në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtares (gradimin) dy nga burimet e vlerësimit për këtë tregues mungojnë. Për rrjedhojë, vlerësimi dhe pikëzimi për këtë kriter do të bëhet duke iu referuar dy burimeve të tjera, si dhe prezumimit se mungesa e ankesave apo të dhënave për shkallën e komunikimit me administratën gjyqësore dhe mungesën e bashkëpunimit, prezumohet se komunikimi dhe bashkëpunimi me administratën gjyqësore është shumë i lartë.

Nga të dhënat mbi verifikimin e ankesave, nuk rezulton asnjë e dhënë ose indicie për mungesë të bashkëpunimit apo për ekzistencën e një shkallë të ulët të komunikimit të gjyqtares me administratën gjyqësore, gjatë periudhës së vlerësimit. Për rrjedhojë, në mungesë të të dhënave që mund të rezultonin nga dy burimet e tjera të vlerësimit dhe mungesës së ndonjë të dhëne të drejtpërdrejtë apo të tërthortë për këtë tregues, prezumohet se ky bashkëpunim dhe komunikim ekziston dhe është në nivel shumë të lartë.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, dhe mungesës së të dhënave për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit të gjyqtares me administratën gjyqësore, prezumohet se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të komunikimit dhe bashkëpunimit me ta.

Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, aftësia e gjyqtares në treguesin “Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 10 pikë.

4.C. GATISHMËRIA E GJYQTARES PËR T’U ANGAZHUAR NË VEPRIMTARI TË TJERA.

Lidhur me këtë nënkriter në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, konkludohet se “..Subjekti i rivlerësimit {...} ka kushtuar rendësi formimit akademik duke marrë pjesë në 11 seminare të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës. Të dhënat tregojnë se ka marrë pjesë gjithsej në 16 ditë për një periudhë 3 vjeçare. Ajo ka marrë pjesë në aktivitete profesionale jashtë programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës por që nuk i përkasin periudhës së rivlerësimit kalimtar...”.

4.C.A. PJESËMARRJA E GJYQTARES NË PROGRAMET E FORMIMIT VAZHDEUES TË SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS DHE NË TRAJNIME TË TJERA PROFESIONALE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Të dhënat e marra nga Shkolla e Magjistraturës;
- Të dhëna nga dosja personale e gjyqtares.

Referuar raportit për analizimin e aftësive profesionale, vërtetimit me nr.649 Prot., datë 21.10.2016, të Shkollës së Magjistraturës dhe formularit të vetëvlerësimit për aftësitë profesionale të gjyqtares, së bashku me dokumentet shoqëruese, rezulton se gjyqtarja {...} është angazhuar në aktivitete trajnuese në cilësinë e pjesëmarrëses në Programin e Formimit Vazhdues në 11 aktivitete trajnuese të zhvilluara në gjithë periudhën e vlerësimit gjithsej 16 ditë. Gjithashtu, rezulton që gjyqtarja të

ketë marrë pjesë në aktivitete profesionale jashtë programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës por që nuk i përkasin periudhës së vlerësimit.

Lidhur me pjesëmarrjen në aktivitete trajnuese, ligji nr. 9877, datë 18.02.2018 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në fuqi në periudhën e vlerësimit, nuk përmbante një parashikim lidhur me detyrueshmërinë e pjesëmarrjes së gjyqtarës në aktivitete trajnuese. Ndërkohë, ky detyrim parashikohej në nenin 23 të ligjit nr.8316/1999 “Për Shkollën e Magjistraturës”, i ndryshuar, sipas të cilit *gjyqtarët dhe prokurorët e gjykatave e të prokurorive të shkollës së parë dhe të gjykatave të apeleve i nënshtrohen formimit vazhdues. Periudha e formimit vazhdues nuk duhet të kalojë më shumë se 20 ditë në vit dhe jo më shumë se 60 ditë gjatë pesë vjetëve.*

Aktualisht, në ligjin nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 5 të tij, pjesëmarrja në programin e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës është përcaktuar si e drejtë dhe njëkohësisht detyrim i gjyqtarës, duke përcaktuar edhe kufirin minimal dhe maksimal të pjesëmarrjes gjatë një viti, si dhe gjatë pesë viteve.³⁷ Në Metodologjinë e Pikëzimit, lidhur me këtë tregues përcaktohet se gjyqtarët kanë detyrimin ligjor të ndjekin programin e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës. Gjyqtarja duhet t'i kushtojë kohë evoluimit të mendimit juridik dhe jurisprudencës dhe të ndjekë programe trajnimi që nxitin specializimin e saj, të organizuara edhe nga institucione të tjera trajnimi, në nivel kombëtar ose ndërkombëtar, të njohura nga Këshilli.

Në lidhje me pikëzimin e aftësisë së gjyqtarës për t'u angazhuar në veprimtari të tjera, treguesi i pjesëmarrjes në programin e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës, matet duke u bazuar në informacionin me shkrim që përcillet nga Shkolla e Magjistraturës, i cili vërteton pjesëmarrjen dhe përfshirjen e magjistratit në trajnime. Pjesëmarrja e gjyqtarës në trajnime të tjera vlerësohet bazuar në dokumente të dorëzuara prej saj, që tregojnë ngritjen profesionale. Referuar sa më sipër, pavarësisht se ligji nr. 96/2016 dhe Metodologjia e Pikëzimit e miratuar me vendimin nr. 264, datë 21.11.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, nuk kanë qenë në fuqi në periudhën e vlerësimit 2013-2016, referuar nenit 23 të ligjit nr. 8316/1999 “Për Shkollën e Magjistraturës”, i ndryshuar, sipas formulimit të tij në periudhën e vlerësimit, rezulton se pjesëmarrja e gjyqtarës në Programin e Formimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës ka qenë e rregulluar nga ky ligj, duke përcaktuar vetëm kufirin maksimal të angazhimit për 1 dhe 5 vjet dhe jo një detyrim minimal pjesëmarrjeje.

³⁷ Në nenin 5 të Ligjit nr. 96/2016, parashikohet se : “1. Magjistrati ka të drejtë dhe detyrimin të marrë pjesë në programet e formimit vazhdues. Magjistrati ka të drejtë të propozojë tema trajnimi dhe të bashkëpunojë me Këshillin, me qëllim përmirësimin e programeve të trajnimit. 2. Magjistrati duhet: a) të ndjekë formimin vazhdues, në përputhje me legjislacionin në fuqi; b) të marrë çdo masë tjetër të arsyeshme për t'u përditësuar me ndryshimet legjislative dhe të jurisprudencës. 3. Periudha e formimit vazhdues duhet të jetë: a) jo më pak se pesë ditë të plota në vit dhe jo më pak se 30 ditë të plota gjatë pesë viteve; b) jo më shumë se 40 ditë në vit dhe 200 ditë gjatë pesë viteve. 4. Magjistrati duhet të përmbushë detyrimin për të marrë pjesë në formimin vazhdues vetëm në ato raste kur programet e trajnimit janë: a) të përshtatshme për funksionin e tij; b) të organizuara dhe certifikuara nga Shkolla e Magjistraturës ose nga çdo institucion trajnimi në nivel kombëtar ose ndërkombëtar të njohur nga Këshilli. Një kopje e certifikatës vendoset në dosjen personale të magjistratit.”

Referuar raportit për analizimin e aftësive profesionale, vërtetimit me nr. 728 Prot., datë 21.10.2016, të Shkollës së Magjistraturës dhe formularit të vetëvlerësimit për aftësitë profesionale të gjyqtarës, së bashku me dokumentet shoqëruese, rezulton se gjyqtarja {...} është angazhuar në aktivitete trajnuese në cilësinë e pjesëmarrësit në Programin e Formimit Vazhdues në 11 (njëmbëdhjetë) aktivitete trajnuese të zhvilluara në gjithë periudhën e vlerësimit, gjithsej 16 (gjashtëmbëdhjetë) ditë trajnimi.

Sa më sipër, referuar të dhënave lidhur me angazhimin e gjyqtaren {...} në aktivitete trajnuese brenda ose jashtë programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës, gjatë periudhës së vlerësimit 2013-2016, pikëzimi për këtë tregues, referuar Metodologjisë së Pikëzimit, do të jetë 20 pikë, meqenëse për periudhën 3 vjeçare rezulton pjesëmarrja e gjyqtarës në programet e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës në 16 ditë trajnimi. Kjo, pasi legjislacioni i kohës parashikonte vetëm kufirin maksimal të pjesëmarrjes në aktivitete trajnuese, por jo një kufi minimal pjesëmarrjeje në aktivitete trajnuese, sikurse përcaktohet aktualisht në nenin 5, të ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, duke marrë në konsideratë frekuencën e angazhimit të gjyqtarës në aktivitetet trajnuese, sipas të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, si dhe në kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi në periudhën e vlerësimit, gjyqtarja duhet të pikëzohet me 20 pikë.

Pjesëmarrja e gjyqtarës në trajnime dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, pjesëmarrja e gjyqtarës në aktivitetet trajnuese të Shkollën e Magjistraturës dhe trajnime të tjera profesionale, pikëzohet me 20 pikë.

4.C.B. DISPONUESHMËRIA E GJYQTARES PËR TË UDHËHEQUR KANDIDATËT PËR GJYQTARË GJATË STAZHIT PROFESIONAL DHE/OSE PËR TRAJNIMIN E GJYQTARËVE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dosja personale e gjyqtarës;

- Informacioni i marrë nga SH.M ose institucione të tjera për përfshirjen e gjyqtares në veprimtari trajnuese.

Referuar burimeve të vlerësimit si më sipër, si dhe formularit të deklarimit për aftësitë profesionale të gjyqtares, nuk rezulton të jetë referuar për angazhimin e tij në veprimtari trajnuese si ekspert ose lehtësues në programin e SH.M, apo të ndonjë institucioni tjetër. Gjithashtu, nuk rezultojnë të dhëna lidhur me gatishmërinë e tij për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional.

Për sa më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij kriteri, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla, jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtares, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t'iu shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari, vlerësoj se për gjyqtaren {...} ky tregues duhet të pikëzohet me 3 pikë.

KONKLuzioni

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton që gjyqtarja të jetë angazhuar në aktivitete trajnuese si ekspert/lektor dhe as angazhimi i saj për udhëheqjen e kandidatëve për gjyqtarë gjatë vitit të stazhit profesional.

***Disponueshmëria e gjyqtares dhe pikëzimi:** Referuar sa më sipër, në treguesin “Disponueshmëria e gjyqtares për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve”, gjyqtarja vlerësohet dhe pikëzohet me 3 pikë.*

4.C.C. ANGAZHIMI I GJYQTARES NË VEPRIMTARI NDËR-INSTITUCIONALE PËR PËRMIRËSIMIN E DREJTËSISË DHE NË VEPRIMTARI PËR MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN NË GJYKATA

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dosja personale e gjyqtares;
- Çdo e dhënë tjetër që tregon për angazhime të kësaj natyre.

Referuar burimeve të vlerësimit si më sipër, si dhe formularit të deklarimit për aftësitë profesionale të gjyqtares, nuk rezulton që gjyqtarja për periudhën e vlerësimit 2013 – 2016 të jetë angazhuar në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e drejtësisë apo veprimtari të tjera, të tilla si: pjesëmarrje në konferenca shkencore mësimdhënie, fjalime publike, pjesëmarrja në aktivitete të edukimit të komunitetit, kontribute për hartimin dhe ndryshimin e legjislacionit etj.

Për sa më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij kriteri, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla, jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtares, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t'iu shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari, vlerësoj se për gjyqtaren {...} ky tregues duhet të pikëzohet me 3 pikë.

Pjesëmarrja, kontributi i gjyqtares dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në treguesin “Angazhimi i gjyqtares në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata”, gjyqtarja vlerësohet dhe pikëzohet me 3 pikë.

4.C.Ç. PUBLIKIMET LIGJORE AKADEMIKE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dosja personale e gjyqtares;
- Çdo e dhënë tjetër që tregon për angazhime të kësaj natyre.

Referuar burimeve të vlerësimit si më sipër, si dhe formularit të deklaramentit për aftësitë profesionale të gjyqtares, nuk rezultojnë që gjyqtarja gjatë periudhës së vlerësimit të ketë realizuar publikime ligjore akademike, me qëllim dhënien e kontributit për zhvillimin e doktrinës. Për sa më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit vlerësoj se për gjyqtaren {...} ky tregues duhet të pikëzohet me 0 pikë.

KONKLuzioni

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezultojnë që gjyqtarja të ketë realizuar publikime ligjore akademike në periudhën vlerësimit dhe për pasojë, ky tregues duhet të pikëzohet me 0 pikë.

Angazhimi i gjyqtares dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në treguesin “Publikime ligjore akademike” nuk rezultojnë angazhimi i gjyqtares, prandaj gjyqtarja pikëzohet me 0 pikë.

Niveli i vlerësimit dhe pikëzimi për kriterin “Aftësitë personale dhe angazhimi profesional”

Niveli i vlerësimit	
KRITERI	
AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL	
Niveli i vlerësimit	Pikët
Shkëlqyeshëm	91

NIVELIN I VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI DHE NIVELIN E PËRGJITHSHËM TË VLERËSIMIT

Niveli i vlerësimit për çdo kriter		
Kriteri	Pikët	Niveli i vlerësimit
1. Aftësitë profesionale të gjyqtares	100	Shkëlqyeshëm
2. Aftësitë organizative të gjyqtares	96	Shkëlqyeshëm
3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale	100	Shkëlqyeshëm
4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional	91	Shkëlqyeshëm
Niveli i përgjithshëm i vlerësimit		
Vlerësimi i përgjithshëm	387	Shkëlqyeshëm

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

SHTOJCA 1

KRITERET E VLERËSIMIT, SHKALLA E AFTËSISË, PIKËZIMI DHE

NIVELI I VLERËSIMIT PËR GJYQTARJAN {...}

PERIUDHA E VLERËSIMIT 2013-2016

1. AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARES			Pikët total	Niveli i vlerësimit	
			100	Shkëlqyeshëm	
Treguesit	Burimet	Shkalla e aftësisë	Pikët	Të dhëna për metodologjinë	
A. Njohuritë ligjore	a. Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short). 	Shumë e lartë	25	Shkalla e aftësisë së gjyqtares: E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë

	b. Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short). 	Shumë e lartë	25	Shkalla e aftësisë së gjyqtares: E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë
B. Arsyetimi ligjor	a. Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short). 	Shumë e lartë	15	Shkalla e aftësisë së gjyqtares: E dobët – 3 pikë Nën mesataren – 6 pikë Mesatare – 9 pikë Mbi mesataren – 12 pikë Shumë e lartë – 15 pikë
	b. Struktura e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar e vendimit	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short). 	Shumë e lartë	10	Shkalla e aftësisë së gjyqtares: E dobët – 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë

					Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë – 10 pikë
	c. Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short). 	Shumë e lartë	25	Shkalla e aftësisë së gjyqtares: E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë
2. AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARES				Pikët total	Niveli i vlerësimit
				96	Shkëlqyeshëm
Tregues		Burimet	Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit	Pikët	Metodologjia
A. Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë	a. Respektimi i afateve ligjore	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short). 	0-10 %	15	Jashtë afatit: Mbi 40 % - 3 pikë 31-40 % - 6 pikë 21-30 % - 9 pikë 11-20 % - 12 pikë

					0-10 % - 15 pikë
	b. Plotësimi i standardeve minimale kohore	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short). 	0-10 %	5	Jashtë afatit: Mbi 40 % - 1 pikë 31-40 % - 2 pikë 21-30 % - 3 pikë 11-20 % - 4 pikë 0-10 % - 5 pikë
	c. Koha mesatare që i dedikohet çdo çështje	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short). 	Më e shkurtër ose e barabartë me standardin për të gjitha kategoritë e çështjeve	5	Koha mesatare: Më e gjatë se standardi për të gjitha kategoritë e çështjeve – 1 pikë Më e gjatë se standardi për shumicën e kategorive të çështjeve – 2 pikë Më e gjatë se standardi për gjysmën e kategorive të çështjeve – 3 pikë Më e shkurtër se standardi për shumicën e kategorive të çështjeve – 4 pikë Më e shkurtër ose e barabartë me standardin për të gjitha

					kategoritë e çështjeve – 5 pikë
	ç. Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit. 	87-93 %	6	Tej standardit : Nën 81 %- 2 pikë Mbi 81-87 % - 4 pikë Mbi 87- 93 % - 6 pikë Mbi 93-99 % - 8 pikë +99% - 10 pikë
	d. Koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar gjyqësor	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short); ▪ Informacioni i përcjellë nga gjykata lidhur me afatin e dorëzimit të vendimit të arsyetuar. 	Më e shkurtër se afati procedural për shumicën e kategorive të çështjeve	15	Koha mesatare: Më e gjatë se afati procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve – 3 pikë Më e gjatë se afati procedural për shumicën e kategorive të çështjeve- 6 pikë Më e gjatë se afati procedural për gjysmën e kategorive të çështjeve- 9 pikë Më e shkurtër se afati procedural për shumicën e kategorive të çështjeve- 12 pikë Më e shkurtër ose e barabartë

					me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve – 15 pikë
B. Aftësia e gjyqtares për të kryer procedural gjyqësore	a. Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre jo-produktive	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short). 	1-3 seanca dhe/ose shkallë shumë e lartë e aftësisë	15	Numri mesatar i seancave dhe shkalla e aftësisë së gjyqtares: Mbi 3 seanca dhe shkallë e dobët e aftësisë – 3 pikë Mbi 3 seanca dhe shkallë mesatare e aftësisë – 9 pikë 1-3 seanca dhe/ose shkallë shumë e lartë e aftësisë – 15 pikë
	b. Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short). 	Shumë e lartë	20	Shkalla e aftësisë së gjyqtares: E dobët- 4 pikë Nën mesataren – 8 pikë Mesatare – 12 pikë Mbi mesataren – 16 pikë Shumë e lartë - 20 pikë
C. Aftësia e gjyqtares për të	a. Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të 	Shumë e lartë	5	Shkalla e aftësisë së

administruar dosjen gjyqësore		përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short).			gjqtares: E dobët- 1 pikë Nën mesataren – 2 pikë Mesatare – 3 pikë Mbi mesataren – 4 pikë Shumë e lartë - 5 pikë
	b. Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short). 	Shumë e lartë	10	Shkalla e aftësisë së gjyqtares: E dobët- 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë - 10 pikë
3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE				Pikët total	Niveli i vlerësimit
				100	Shkëlqyeshëm
Tregues		Burimi	Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit	Pikët	Metodologjia
A. Etika në punë	a. Angazhimi dhe përgjegjshmëria në	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit. 	Shumë e lartë	35	Shkalla e etikës në punë e

	funksion				gjqtares: E dobët- 7 pikë Nën mesataren – 14 pikë Mesatare – 21 pikë Mbi mesataren – 28 pikë Shumë e lartë – 35 pikë
B. Integriteti i gjyqtares	a. Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit. 	Shumë e lartë	40	Shkalla e integritetit të gjyqtares : E dobët – 0 pikë Shumë e lartë – 40 pikë
C. Paanësia e gjyqtares	a. Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short). 	Shumë e lartë	10	Aftësia për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese: E dobët- 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë- 10 pikë

	b. Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtares	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit. 	I pa konsiderueshëm	15	Numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtares: Tejet i lartë – 3 pikë I pa konsiderueshëm – 15 pikë
4. AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL				Pikët total	Niveli i vlerësimit
				91	Shkëlqyeshëm
Tregues		Burimi	Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit	Pikët	Metodologjia
A. Aftësia e komunikimit	a. Komunikimi i qartë dhe transparent	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short). 	Shumë e lartë	25	Qartësia dhe transparencja e komunikimit: E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë
	b. Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të 	I lartë	15	Respektimi i

		përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short).			konfidencialitetit: I dobët- 3 pikë Mesatar – 9 pikë I lartë – 15 pikë
B. Aftësia për të bashkëpunuar	a. Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta	▪ Dosja e rivlerësimit.	Shumë e lartë	15	Shkalla e komunikimit: E dobët – 3 pikë Nën mesataren – 6 pikë Mesatare – 9 pikë Mbi mesataren – 12 pikë Shumë e lartë – 15 pikë
	b. Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore	▪ Dosja e rivlerësimit.	Shumë e lartë	10	Shkalla e komunikimit: E dobët – 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë – 10 pikë
C. Gatishmëria e gjyqtarës për t'u angazhuar në	a. Pjesëmarrja e gjyqtarës në programin e formimit vazhdues në Shkollën e Magjistraturës dhe në trajnime të tjera	▪ Dosja e rivlerësimit.	15-120 ditë	20	Pjesëmarrja e gjyqtarës:

veprimtari të tjera	profesionale				(periudha 3/vjeçare) 15-120 ditë – 20 pikë <15 ose > 120 ditë: 4
	b. Disponueshmëria e gjyqtares për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve	▪ Dosja e rivlerësimit.	Nuk ka të dhëna	3	Nuk ka të dhëna – 3 pikë Ka të dhëna – 5 pikë
	c. Angazhimi i gjyqtares në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata	▪ Dosja e rivlerësimit.	Nuk ka të dhëna	3	Nuk ka të dhëna – 3 pikë Ka të dhëna – 5 pikë
	ç. Publikimet ligjore akademike	▪ Dosja e rivlerësimit.	Nuk ka të dhëna	0	Nuk ka të dhëna – 0 pikë Ka të dhëna – 1 deri në 5 pikë
PIKËZIMI PËR KATËR KRITERET E VLERËSIMIT		387			
NIVELI PËRFUNDIMTAR I VLERËSIMIT TË GJYQTARES		Shkëlqyeshëm			

PËR KËSHILLIN E L

ARTË GJYQËSOR